



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 1 (827805)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 6 janar 2023

Arritjet e Ministrisë së Mbrojtjes në rrugëtimin e saj përgjatë vitit 2022

Viti 2022 numëron një sërë arritjesh për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Nga nisja e punës për ndërtimin e Bazës Ajrore taktike të NATO-s në Kuçovë, nënshkrimi i kontratës së shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, janë vetëm dy nga arritjet që shënjuan këtë vit. Me vendim qeverie, u rritën në masën 30% pagat për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura, me angazhimin në buxhetin e shtetit për një tjetër rritje gjatë vitit që

vjen. Falë bashkëpunimit të rëndësishëm dhe partneritetit strategjik me SHBA-të, ky vit mban rekordin e projekteve për modernizimin e FA-ve e tre prej tyre janë: nisja e zbatimit të projektit për ngritjen dhe fuqizimin e Njësisë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike, përfundimi i fazës së parë të projektit të komunikimit Tokë-Ajër-Tokë (GAG), dhe pajisja me sistemin raketor antitank "Javelin" dhe atë kundërajror "Stinger". Një tjetër aspekt i rëndësishëm për FA-të është edhe fakti se SHBA-ja ak-

tivizoi në Shqipëri Shtabin e Përparuar të Komandës së Forcave Speciale amerikane. Së fundmi Shqipëria nënshkroi edhe marrëveshjen për shtimin e flotës ajrore me avionë luftarakë pa pilotë "Bayraktar" me kompaninë turke "Baykar". I suksesshëm rezultoi për Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë ky vit, pasi u certifikua si "Combat ready" nga NATO - Grup. Gjatë këtij viti nisi zbatimi i projektit që shndërron Akademinë e FA-së nën modelin amerikan "West Point", ndërsa... >>> faqe 4



Presidenti Begaj: Ju jeni aset i më i çmuar i Forcave të Armatosura. Faleminderit për shërbimin që i bëni kombit!



>>> faqe 2-3



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Krenarë për FA-të, na kanë dhënë të drejtën të kemi një pozicion të merituar në NATO



SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji: Mbështetja dhe përpjekjet e mia do të mbeten të pakufizuara ndaj çdo ushtaraku të FA-së

Niset në hapësirë raketa "Falcon 9" me dy satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2"

Raketa "Falcon 9", misioni i përbashkët i SpaceX Transporter 6, e cila transporton edhe satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2", u lëshua në hapësirë nga stacioni Cape Canaveral, Florida, më datë 03.01.2023 në orën 9:56 me orën lokale, 14:56 me orën në Tiranë. Dy satelitët lëshohen në kuadër të kontratës së shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Operatorit "Satellogic USA Inc.", me vlerë 6 milion dollarë...



>>> Faqe 4

58 vite nga lundrimi i parë i anijeve luftarake nga ishulli i Sazanit për në Bazën Detare të Durrësit

Nga fundi i vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes i asaj kohe vendosi rishikimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotilja e Durrësit dhe Flotilja e Vlorës. Si kriter bazë i caktimit të kuadrove do të merrej vendbanimi Durrës, dhe kjo për efekte strehimi. Në përbërje të Flotiljes Durrës u caktuan anije minahëqëse, gjuajtëse kundër ND si dhe anije ndihmuese. Komandant ishte caktuar Dashmir Ohri...



>>> Faqe 5

Udhëtim në shkollën "Skënderbej"

Intervistë me ish-kolonelin Dhimitër Janaqi, ish-skënderbegas

Shkolla e mesme ushtarake "Skënderbej" u hap, më 28 mars 1945, vetëm pak muaj pas çlirimit të Shqipërisë. Që në dhjetor 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, i kishte dërguar njësitë ushtarake një letër që të përzgjidhnin partizanët e vegjël, 12 - 15-vjeçarë, për t'i dërguar në shkollën ushtarake, e cila do të hapet së shpejti pranë garnizonit ushtarak në fund të rrugës së Dibrës, afër spitalit civil. Pas dy vitesh, me vendim të posaçëm, ajo do të quhej shkolla e mesme ushtarake "Skënderbej" dhe që nga 28 marsi i vitit 1945, kjo shkollë...



>>> Faqe 6-7

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Krenarë për FA-të, na kanë dhënë të drejtën të kemi një pozicion të merituar në NATO

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, zhvilluan një bashkëbisedim online me të gjithë përfaqësuesit e Shqipërisë në misione jashtë vendit, të cilët i përgëzuan për kontributin dhe punën e bërë gjatë këtij viti tejet të ngarkuar për sigurinë dhe paqen në botë.

“Gjatë vitit që po lëmë pas, puna juaj dhe e FA-së dhe në veçanti e atyre që janë në misione ndërkombëtare ka marrë një tjetër përmasë. Ky ishte një vit me lajme jo të mira për sigurinë dhe paqen, ishte një vit kur skena e sigurisë u trondit për shkak të invazionit rus në Ukrainë dhe kjo bëri që siguria dhe paqja si domein të vendosen në qendër dhe të jenë prioritet i prioriteteve për të gjithë botën”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi e nisi bisedën me Misionin e Shqipërisë pranë KFOR-it në Kosovë, duke folur edhe për situatën atje.

“Së fundmi tensioni është rritur. Ju jeni pjesë e KFOR-it, e strukturës së NATO-s që garanton sigurinë. Të gjitha fenomenet që kërkojnë të krijojnë destabilitet në rajon janë derivat i asaj çka ndodhi në shkurtin e këtij viti në Ukrainë dhe vazhdon të jetë sot një nga shqetësimet kryesore të botës. Kjo ngjarje na vuri përpara detyrave, të cilat nuk i kishim menduar në një kohë kaq të afërt, lidhur me modernizimin, lidhur me investimet në arsimim, në shtimin e prezencës sonë në misione ndërkombëtare, pra në ndërtimin e një force të armatosur më të fortë, më të aftë dhe më shpresëdhënëse për të gjithë bashkatdhetarët tanë në Shqipëri, por edhe në rajon, për të garantuar paqen dhe sigurinë në Ballkan dhe në të gjithë hapësirën e Aleancës së NATO-s”, - theksoi ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes foli për një dimension të ri që ka marrë bashkëpunimi me NATO-s, ku përmendi aleancën strategjike me SHBA-të, por edhe bashkëpunimin me BE-në, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e përfaqësuesve tanë në këto misione të rëndësishme: “Ju bëni krenar sot të gjithë popullin shqiptar. Ju jeni një vlerë e shtuar edhe në NATO. Ndonëse jemi një popull i vogël, një aleat i vogël, ne duam të tregojmë se nuk jemi vetëm konsumatorë, por edhe duam të kontribuojmë. Ne jemi me forca më të shtuara në misionet e NATO-s. Kemi



një reputacion shumë të mirë. Ju na keni hapur syrin dhe na keni dhënë gjithë të drejtën të kemi një pozicion shumë të merituar në NATO”, - u tha ministri Peleshi përfaqësuesve të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare.

Gjatë bisedës, z. Peleshi foli edhe për objektivat që Ministria e Mbrojtjes ka për vitin 2023: “Ky është viti kur ne bëmë një ndryshim sasior dhe cilësor në shpërblimin e FA-së. Kemi rritur 30%

pagat për të gjithë efektivët, nga ushtari bazë dhe deri te gradat më të larta. Angazhimi dhe premtimi i kryeministrit për të patur një rritje të vazhdueshme dhe të përvitshme deri sa të arrijmë nivelin më të lartë në rajon do të realizohet. Vitin që vjen do e rrisim edhe 7 % të tjera pagën mbi atë 30% që u rrit gjatë vitit 2022”, - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas tij, në 2023 fillon puna për ndërtimin e korpusit të Akademisë së

FA-së, ndërsa Flota e Forcës Ajrore do të shtohet edhe me helikopterë të tjerë “Black Hawk”, duke e çuar në 6 numrin e helikopterëve.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se është bërë mjaft progres në punën për ndërtimin e Bazës së parë Taktike Ajrore të NATO-s në Kuçovë dhe pritet që për rreth një vit ajo të jetë gati.

Një tjetër projekt i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin që vjen është edhe

ndërtimi i një porti të ri ushtarak në Porto Romano pranë portit tregtar, i cili, sipas ministrit Peleshi, do t'i japë Shqipërisë një rëndësi të shtuar strategjike, pasi ky port do të jetë porta e hyrjes dhe e dislokimit të forcave aleate nga Ballkani Perëndimor drejt Lindjes.

Duke uruar përfaqësuesit e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare jashtë vendit, ministri Peleshi tha se viti që vjen do të jetë më i mirë edhe për sigurinë, pasi të gjithë aleatët janë bashkuar në krahun e paqes.

Edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji vlerësoi misionin e përfaqësuesve tanë, duke theksuar se: “Viti 2023, për të gjithë ne, vjen me detyrime të reja edhe më të shumta, por unë ju siguroj se edhe vëmendja dhe mbështetja e të gjithë autoriteteve të vendit, do të jetë shumë më e shtuar dhe e ndjeshme gjatë vitit 2023. Forcat e Armatosura do të jenë edhe më mirë, por njëkohësisht do të bëjnë edhe më të mirën gjatë vitit që vjen”.



Presidenti Begaj: Ju jeni asetë më i çmuar i Forcave të Armatosura. Faleminderit për shërbimin që i bëni kombit!

Presidenti i Shqipërisë Bajram Begaj, i ka uruar të gjithë ushtarët shqiptarë që shërbejnë në misione ndërkombëtare me rastin e fillimit të vitit të ri 2023.

Presidenti Begaj shprehu vlerësimin e tij për ushtarakët, që shpesh dhe në raste festash ndodhen larg familjeve të tyre, duke shërbyer nga Kosova në Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Letoni, Irak dhe deri në Sudanin e Jugut.

“Shërbimi juaj përkrah aleatëve është një shërbim që përshkohet nga sakrificat, përkushtimi, përgjegjëshmëria dhe disiplina e lartë që karakterizon Forcat e Armatosura”, - tha Begaj.

Më tej presidenti theksoi se viti 2022 ishte një vit shumë i vështirë, ku agresioni i pajustificuar i Rusisë ndaj Ukrainës rrezikoi paqen dhe sigurinë në hapësirën euro-atlantike, ndërsa efektet e saj ndihen në jetën e çdo qytetari.

Begaj shtoi se Shqipëria si anëtarë e NATO-s do të vazhdojë të japë kontributin e saj: “Si anëtar i NATO-s, vendi ynë do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë aktive në misione dhe operacione të drejtuara nga NATO, si dhe do të rrisim kontributet tona aty ku do të jetë e nevojshme dhe do të na kërkohet”, - shtoi Begaj.

“Këto ditë kam ndjekur me shqetësim ngjarjet në veri të Kosovës. Shqipëria si një vend anëtar i NATO-s është e përkushtuar dhe mbështet misionin e KFOR-it, që ne e cilësojmë si



një histori suksesi. Unë ju falënderoj ju si kontingjent që jeni atje, për të gjithë përkushtimin e treguar në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë”, - theksoi ai. “Forcat e Armatosura janë shumë të rëndësishme për një vend dhe

unë sot nëpërmjet jush gjej rastin të falënderoj të gjitha Forcat e Armatosura shqiptare për përkushtimin e treguar në përbushjen e çdo detyre kushtetuese, por edhe në përballimin e atyre situatave të cilat kanë qenë jo të pakta gjatë vitit,

si emergjencat e ndryshme”, - shtoi më tej Presidenti. “Për mua, ju jeni asetë më i çmuar i Forcave të Armatosura. Mund të marrim pajisje mjaft të mira teknologjike, por nëse nuk kemi njerëz për t’i përdorur ato nuk kemi bërë asgjë.

Me këtë rast edhe njëherë ju uroj festa të gëzuara, shëndet e mbarësi për ju dhe familjet e juaja. Gëzuar Vitin e Ri 2023! Shumë faleminderit për shërbimin që i bëni kombit”, - e mbylli falënderimin presidenti Begaj.

SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji: Mbështetja dhe përpjekjet e mia do të mbeten të pakufizuara ndaj çdo ushtaraku të FA-së

Të dashur ushtarakë dhe punonjës civilë të Forcave të Armatosura!

Atmosfera festive e këtij fund viti na sjell së bashku me familjet, miqtë, shokët e kolegët, për të festuar me njëri-tjetrin.

Teksa reflektojmë mbi dymbëdhjetë muajt që lamë pas, e vlerësoj me admirim punën dhe përkushtimin tuaj në realizimin e detyrave që ju janë ngarkuar. Të gjithë ne, jemi krenarë që punojmë përkrah njerëzve të motivuar dhe të dedikuar në këtë profesion sa fisnik dhe sfidues, që bën diferencën në komunitetet tona ku jetojmë dhe shërbejmë.

Disa prej nesh këto festa i gjejnë larg atdheut, në krye të detyrës krahas për krahas me aleatët tanë. Forcat e Armatosura vijojnë kontributin e rëndësishëm në misionet jashtë vendit, si Kosovë, Letoni, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Irak dhe Sudanin e Jugut, ku mbajnë lart emrin dhe flamurin e vendit.

Një kontribut të rëndësishëm kemi shënuar edhe në mbështetje të organeve të pushtetit qendror dhe popullsisë gjatë emergjencave të ndryshme civile.



Efektivët tanë janë të parët që janë aty për të mbështetur edhe kur emergjencat dhe nevojat i kalojnë kufijtë e mundësive të këtyre institucioneve.

Përgjatë vitit 2022, njësitë tona u an-

gazhuan në stërvitje të shumta brenda dhe jashtë vendit, të cilat përfshijnë një shkallë të gjerë trupash, mjetes, pajisjesh, si në stërvitje dimërore, verore, po ashtu në stërvitjet bilaterale dhe shumëkombëshe në

bashkëpunim me vendet partnere strategjike dhe aleate.

Këto stërvitje, përpos testimit të kapaciteteve operacionale, kanë rritur ndjeshëm ndërveprueshmërinë dhe gatishmërinë e njësisë tona për t’u përgjigjur në çdo situatë dhe në çdo kohë. Forcat e Armatosura tashmë kanë në përbërjen e tyre një grup - batalion të gatshëm në shërbim të nevojave të Aleancës.

Viti 2023 do të vijojë të jetë i mbushur me detyra dhe sfida, të cilat jam më se i bindur se në sajë të eksperiencës dhe përkushtimit tuaj do të arrijmë t’i përballojmë me sukses.

Përpara na presin dy stërvitje të mëdha me rëndësi kombëtare: “Defender Europe - '23” dhe “Strong Balkan - '23”, ku kërkohet nga ne një angazhim serioz dhe ku do të dëshmojmë se FA-të kanë kapacitetet e duhura të veprojnë dhe ndërveprojnë si një forcë kohezive e përbashkët.

Modernizimi, investimet në infrastruk-

turë dhe përmirësimi i kushteve për jetesë dhe stërvitje do të jetë prioriteti ynë, duke ndërthurur standardet më të mira në fushën e arsimit, edukimit, trajnimit dhe stërvitjes, me synim zhvillimin e një force të armatosur me aftësi dhe kapacitete reale për të zgjidhur me sukses situata të krizave të ndryshme dhe të kryejnë shërbime jetike për vendin dhe gjatë angazhimeve ndërkombëtare, si pjesë e NATO-s.

Sot është dita e duhur për të përsëndetur të gjithë pjesëtarët e Forcave të Armatosura, që kanë shërbyer ndër vite dhe ata që vazhdojnë dhe shërbejnë, prandaj ju drejtohem për t’ju përcjellë nga zemra juve dhe familjeve tuaja, urimet më të mira për një Vit të Ri me shëndet dhe i mbushur me gëzime në të gjitha fushat.

Duke ju siguruar se mbështetja dhe përpjekjet e mia do të mbeten të pakufizuara edhe njëherë, kujdesuni për veten, familjet tuaja dhe njëri - tjetrin!

Gëzuar Vitin e Ri 2023!

Arritjet e Ministrisë së Mbrojtjes në rrugëtimin e saj përgjatë vitit 2022

Viti 2022 numëron një sërë arritjesh për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Nga nisja e punës për ndërtimin e Bazës Ajrore taktike të NATO-s në Kuçovë, nënshkrimi i kontratës së shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, janë vetëm dy nga arritjet që shënuan këtë vit.

Me vendim qeverie, u rritën në masën 30% pagat për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura, me angazhimin në buxhetin e shtetit për një tjetër rritje gjatë vitit që vjen.

Falë bashkëpunimit të rëndësishëm dhe partneritetit strategjik me SHBA-të, ky vit mban rekordin e projekteve për modernizimin e FA-ve e tre prej tyre janë: nisja e zbatimit të projektit për ngritjen dhe fuqizimin e Njësisë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike, përfundimi i fazës së parë të projektit të komunikimit Tokë-Ajër-Tokë (GAG), dhe pajisja me sistemin raketor antitank "Javelin" dhe atë kundërajror "Stinger".

Një tjetër aspekt i rëndësishëm për FA-të është edhe fakti se SHBA-ja aktivizoi në Shqipëri Shtabin e Përparuar të Komandës së Forcave Speciale amerikane.

Së fundmi Shqipëria nënshkroi edhe marrëveshjen për shtimin e flotës ajrore me avionë luftarakë pa pilotë "Bayraktar" me kompaninë turke "Baykar". I suksesshëm rezultoi për Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë ky vit, pasi u certifikua si "Combat ready" nga NATO - Grup.



Gjatë këtij viti nisi zbatimi i projektit që shndërron Akademinë e FA-së nën modelin amerikan "West Point", ndërsa nisi edhe viti i parë akademik në Kolegjin e Mbrojtjes.

Shqipëria vazhdon të jetë, me sukses, eksportuese e paqes me 7 misione jashtë vendit, duke u bashkuar rishtas në misionin e ri të NATO-s në Novo Selo, Bullgari.

Që nga nisja e agresionit rus në shkurt të 2022, Shqipëria u rreshtua në anën e paqes dhe sigurisë, duke qenë një mbështetëse aktive në nivel politik dhe ushtarak për Ukrainën.

Emergjencat civile morën një tjetër vëmendje të shtuar. Shqipëria u bë anëtare e Mekanizmit European të Mbrojtjes Civile, ndërsa u themelua Qendra Kombëtare Operacionale

e Emergjencave Civile. Po ashtu u nënshkrua edhe marrëveshja e huasë me qeverinë italiane prej 30 milion eurosh për fuqizimin e Sistemit të Mbrojtjes Civile. U mbështetën 13 projekte për Bashkitë për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Sporti dhe kultura morën një dimension të ri brenda FA-së. U krijua një strukturë e posaçme e sportistëve

elitarë pranë Ministrisë së Mbrojtjes si dhe u ngrit Orkestra Simfonike dhe kori i Forcave të Armatosura. Me rastin e 110 - Vjetorit të Pavarësisë dhe 110 - vjetorit të krijimit të FA-ve, 300 artistë nga vendet e NATO-s dhe Kosova performuan në Tiranë.

Pas një ndërprerjeje disa vjeçare, del print revista "Mbrojtja", organ i Ministrisë së Mbrojtjes.

Niset në hapësirë raketa "Falcon 9" me dy satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2"

Raketa "Falcon 9", misioni i përbashkët i SpaceX Transporter 6, e cila transporton edhe satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2", u lëshua në hapësirë nga stacioni Cape Canaveral, Florida, më datë 03.01.2023 në orën 9:56 me orën lokale, 14:56 me orën në Tiranë.

Dy satelitët lëshohen në kuadër të kontratës së shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Operatorit "Satellogic USA Inc.", me vlerë 6 milion dollarë.

Në bazë të kontratës, dy satelitët do të përdoren për një periudhë 3 - vjeçare, për monitorimin e territorit të Republikës së Shqipërisë, zhvillimin e kapaciteteve teknike e profesionale të Republikës së Shqipërisë për përdorimin e shërbimit satelitor, përpunimin e informacionit gjeohapësinor (GIS) si dhe ofrimin e produkteve të imazherisë dhe komponentëve të tjerë të saj. Ky shërbim do t'u mundësojë institucioneve përfituese marrjen e Imazheve satelitore, të cilat sigurojnë një mbulim gjithëpërfshirës dhe periodik të sipërfaqes tokësore, duke mundësuar përdorime të shumta dhe një mori informacionesh dhe gjeoinformacioni për vendimmarrësit dhe planifikuesit si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, për politika dhe vendimmarrje efektive.



58 vite nga lundrimi i parë i anijeve luftarake nga ishulli i Sazanit për në Bazën Detare të Durrësit

Nga fundi i vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes i asaj kohe vendosi rristurimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbijetëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotilja e Durrësit dhe Flotilja e Vlorës.

Si kriter bazë i caktimit të kuadrove do të merrej vendbanimi Durrës, dhe kjo për efekte strehimi. Në përbërje të Flotiljes Durrës u caktuan anije minahëqëse, gjuajtëse kundër ND si dhe anije ndihmuese. Komandant ishte caktuar Dashmir Ohri. Ai vinte nga një përvojë e pasur si ish-komandant i bazës së nëndetëseve të Pashalimanit, pikërisht në periudhën kur ishte krijuar konflikti i madh me aleatin e atëherëshëm, Bashkimin Sovjetik. Ai është dhe një nga 17 oficerët e parë shqiptarë që ka mbaruar studimet në vitin 1947 në ish-Jugosllavi. Dashmir Ohri ka qenë komandant i nëndetësës së parë shqiptare, të ardhur me një katërshe nga Bashkimi Sovjetik.

Vitin e ri 1965 e festuam së bashku në Sazan

Në mesditën e 4 janarit 1965, kapiteni i Rangut III-të D. Ohri, i emëruar komandant i Flotiljes Durrës, organizon një takim me kuadrot e Shtabit të Flotiljes dhe komandantët e anijeve; i njeh me planin e lundrimit të Flotiljes nga Sazani në Durrës. Rreth orës 20:00 fillon dalja e anijeve nga Sazani. Ky moment ishte shumë prekës. Dalja e anijeve u shoqërua me rënien e sirenavë si përshëndetje tradicionale e FLD-së. Lundrimi për në Durrës u bë natën, në formacion lundrimi dhe në kushtet e një deti të trazuar.

Në mëngjesin e datës 05 janar 1965, anijet mbërritën në Radin e Durrësit, e më pas u akostuan në Kalatën Lindore të Portit Detar Durrës. Kështu data 5 janar 1965 shënon ditën e rikrijimit të Bazës Detare Durrës. Para komandës e shtabit të Flotiljes dilnin detyra për konsolidimin e vendbazimit. Nisi gjithçka nga e para sepse mungonte infrastruktura, si bankinat, godina e komandës, kushtet e përgatitjes speciale, depot, baza materiale për përgatitjen e efektivave etj.

Në saje të punës vetëmohuese të kuadrove dhe efektivave, u arrit që të ndërtohej bankina e silurë-hedhësve, ofiçina e silurëve si domosdoshmëri për anijet që pritej të vinin në vitin 1965 nga RP e Kinës. Ndihej të madhe për sigurimin e kushteve të vendbazimit dhanë edhe ndërmarrjet e qytetit të Durrësit si NN Porti, Porti Detar etj.

Rruga në të cilën ka ecur Baza Detare e Durrësit gjatë këtyre viteve ka qenë e mbushur me sakrificë në kryerjen e detyrave për mbrojtjen e ujërave tona territoriale nga veprimtaritë e paligjshme të anijeve të huaja, ndalimin e tentativave për kontrabandë etj.

Në vite, Bazës iu shtuan anije të tjera si silurë-hedhëse, gjuajtës detar; u

ndërtuan vendbazimi në B. Pallë, ofiçina të riparimit të anijeve, godina e komandës, shkolla e përgatitjes së efektivave etj.

Janë të shumtë ish-detarët që kanë kryer shërbimin ushtarak në Bazën e Durrësit që punojnë në profesione të ndryshme në Flotën Tregtare, në Flotën e Peshkimit etj. Në këtë 58-vjetor të rikrijimit të Bazës Detare të Durrësit, për punën plot përkushtim në shërbim të atdheut kujtojmë me nderim e respekt kuadrot e para që hodhën themelet e rikrijimit dhe konsolidimit të Bazës, të cilët janë ndarë nga jeta, si: komandantët e Bazës në vite kapiten rangut III D. Ohri, kapiteni i rangut I M. Plani, shefi i Shtabit të Bazës, kapiteni i rangut III M. Lulolli, komandantët e skuadriljeve silurë-hedhëse, kapiteni i rangut III Selam Qejvani, kapiteni i rangut III Ali Canosinaj, komandantin e grupit të anijeve mbijetëse Petro Treni, Inxhinierë, mekanikët Piro Tushi, Ismet Beluli, Sami Shyti, Mark Berdufi, M. Hysi; kuadrot me përvojë Xh. Bujari, Vasil Petro, Spiro Kote, A. Sevrani, B. Demko, Mihallaq Papadhropulli, B. Shehu, T. Gërveni, Skënder Sulku, Halit Hima, Thoma Rubia, B. Kelmendi, S. Beluli, I. Rexha etj., si dhe Tasim Sinani, Hektor Meçe, A. Daja, D. Hoxha, që u larguan nga jeta shumë para kohe. Le t'u shërbejë përvoja e tyre brezave të kuadrove të rinj të Bazës Detare të Durrësit.

Me ndryshimin e sistemit politik në vitin 1990, Baza detare e Durrësit pësoi ndryshimet e veta në konceptin e

detyrave, organizim dhe strukturë. Si rezultat i hapjes me botën, në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona; u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafikë të klandestinëve, të drogës, të armëve etj. Baza Detare e Durrësit i ka përballuar të gjitha detyrat në ndalimin e këtyre veprimtarive të paligjshme. Në këtë aspekt kontribut ka

dhënë edhe bashkëpunimi me anijet e Flotave Ushtarake të NATO-s. Vlen të përmenden veprimtaritë e përbashkëta të mjeteve të Bazës Detare të Durrësit për embargo ndaj ish-Jugosllavisë, duke ndaluar misionet kontrabande, anije naftëmbajtëse etj. Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tona kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere. Rol të rëndësishëm në zbatimin e

detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiuara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknikë bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA-të, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale.



NJË JETË E MBUSHUR PLOT ME SFIDA DHE SAKRIFICA

Udhëtim në shkollën "SKËNDERBEJ"

Intervistë me ish-kolonelin Dhimitër Janaqi, ish-skënderbegas

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Shkolla e mesme ushtarake "Skënderbej" u hap, më 28 mars 1945, vetëm pak muaj pas çlirimit të Shqipërisë. Që në dhjetor 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, i kishte dërguar një ushtarake një letër që të përzgjidhnin partizanët e vegjël, 12 - 15-vjeçarë, për t'i dërguar në shkollën ushtarake, e cila do të hapej së shpejti pranë garnizonit ushtarak në fund të rrugës së Dibrës, afër spitalit civil. Pas dy vitesh, me vendim të posaçëm, ajo do të quhej shkolla e mesme ushtarake "Skënderbej" dhe që nga 28 marsi i vitit 1945, kjo shkollë do të bëhej simbol i nderit dhe i krenarisë të Ushtrisë Shqiptare, një "fidanishte e vërtetë", ku u edukuan dhe u brumosën me cilësitë e virtutet më të larta breza të tërë djemsh të ardhur nga e gjithë Shqipëria për t'i shërbyer më pas me devotshmëri të lartë atdheut dhe popullit të tyre. Gjatë ekzistencës së saj, afër 60-vjeçare, kjo shkollë u përfshi në të gjithë sektorët e jetës mbarëkombëtare, ajo u bë një shkollë shumëdimensionale në vend. Për gati gjysmë shekulli (1945-1992) nga kjo shkollë dolën rreth 32 000 nxënës, dhe jo vetëm ushtarakë të gradave të ndryshme dhe të larta, por edhe mjaft personalitete që kontribuan në shkencë, diplomaci, kulturë, ndërtim, arsim etj.

Gazeta "Ushtria" ka hapur një vend të veçantë për këta ish-ushtarakë skënderbegas, duke i sjellë herë pas herë në faqet e saj. Më poshtë intervista me ish-skënderbegasin, ish-kolonel Dhimitër Janaqi, një prej drejtuesve ushtarakë.

Ju më thatë se fëmijëria juaj e hershme, ashtu si dhe ndoshta e shumë fëmijëve të tjerë të pas Luftës të Dytë Botërore, nuk ishte e lehtë. Jeni rritur me shumë vështirësi, por me shumë dashuri, në një familje të madhe me 8 fëmijë. Kur dëgjuat ju për shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej"? Si shkuat në këtë shkollë?

Teksa marr pyetjen tuaj për këtë intervistë, si fillim dua t'ju falënderoj për hapësirën dhe vendin që po i kushtoni në gazetën "Ushtria" ish-ushtarakëve, por sidomos ne ish-skënderbegasve, pasi ajo shkollë ka qenë vërtet "një fidanishte", ashtu siç edhe e quajmë. Kjo, jo vetëm për moshën e re kur ne na u desh të vishnim këmbalet ushtarake, ishim vetëm 13-14 vjeç, por dhe për atë që u bëmë më tej, ushtarakë të devotshëm, të përkushtuar dhe me zemrën të mbushur plot me atdhedashuri. Unë jam i datëlindjes 26 tetor 1946, kam lindur në Tiranë vetëm dy vjet pas çlirimit të Shqipërisë dhe përfundimit të luftës Nacionalçlirimtare. Isha fëmija i parë i një familjeje të varfër dhe siç mund të merret me mend se çfarë kishte lënë pas Lufta e Dytë Botërore. Ju keni mësuar nga librat e historisë se si ishte ajo kohë, rrënim, rindërtim, ringritje, po e quaj atë kohë nëpër të cilën eci Shqipëria e pas luftës. Fëmijëria jonë ishte e varfër, tepër e varfër. Shkollën 7-vjeçare, e kam kryer në shkollën "Ali Demi", në vitin 1959 në Tiranë, me rezultate të shkëlqyera në të gjitha lëndët që zhvilloheshin atëherë. Dhe për të ardhur tani tek pyetja juaj.

Në atë kohë funksiononin grupet e rinisë, të cilat pasonin ato të pionierëve



për moshat më të vogla të shkollës 7-vjeçare, dhe mësuesja e fizkulturës por dhe ajo e matematikës, që drejtonin këto organizata të rinisë, na foli ne dhe na tregoi mbi shkollën e Mesme të Përgjithshme "Skënderbej". Unë isha nxënës shumë i mirë, jo vetëm në mësim por edhe në fizkulturë dhe këto dy mësuese ishin nxitja e parë. Ato kontaktuan dhe folën me babanë tim për mua dhe madje iu lutën atij që të filloja këtë shkollë. Në fillim patëm pak hezitim në familje, pasi siç thashë isha fëmija e parë, krahu i punës për familjen, por babai ishte ai që vendosi që të shkoja në shkollë më tej. Ajo që e lehtësonte shkollimin tim përveç si nxënës i mirë që isha, ishte edhe ana ekonomike pasi shkolla e Mesme e Përgjithshme "Skënderbej", ofronte gjithçka, ishte shkollë me konvikt, por gjithashtu një nga shkollat më të forta në vend për nga mësimdhënia.

Si u ndjetë mes bashkëmoshatarëve?

Nuk e dija se ku ndodhej shkolla por kryetari i Degës Ushtarake në atë kohë, më solli në shkollën "Skënderbej" dhe ajo që pashë sa u futa ishte një shkollë

e bukur, shumë e bukur. Ne na sollën në shkollë një muaj para se sa të fillonte mësimi për t'u familjarizuar me gjithçka që do të ofronte shkolla "Skënderbej" për ne, si dhe për t'u njohur me jetesën në shkollë dhe në konvikt, por edhe me shokët. Ishim të gjithë moshatarë dhe pothuaj që të gjithë vinim nga e njëjta shtresë shoqërore dhe me të njëjtat kushte familjare. Ishin vitet e para të çlirimit. Të gjithë ishim fëmijë të sjellshëm, e respektonim dhe ndihmonim shumë njëri tjetrin. Në familje në shtëpinë time, jam kthyer pas një muaji, më ka çuar Adem Çobani, që më vonë u bë gjeneral, ai ishte gjithashtu shoku i fëmijërisë sime, pasi ishim rritur në një lagje, por ai ishte më i madh se unë, dy vjet më sipër në shkollën "Skënderbej". Kur filluam mësimin në të vitit të parë u ndamë në tre kompani dhe programi ndësimor zgjaste 4 vjet. Ndërkohë në shtëpi shkoja një herë në javë, pas mësimi.

Çfarë e bënte shkollën tuaj të ishte ndryshe nga të tjerat?

Ne kemi qenë më të mirët. Nga programi mësimor ishim njëlloj si shkollat

e tjera të përgjithshme, por edukimin ushtarak e bënim më të thelluar se ato. Shpesh zhvillonim olimpiada të ndryshme me gjimnazet, si "Petro Nini" p.sh., por edhe me shkollat e tjera dhe gjithmonë dilnim shumë mirë. Lëndët mësimore i kishim njëlloj, njohuritë mësimore i kishim të njëjta. Ajo që na veçonte ishte edukata ushtarake edhe si lëndë mësimore dhe si edukim në përgjithësi, korrektësi, gjithçka me orar dhe disiplinë. Për shembull, ne sa shihnim makinën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, në atë kohë gjeneral Dume, sa shihnim "kaprollin" e tij të vinte, ne gjithmonë merrnim drejtqëndrim.

Stërviteshim në palestër, e cila ndodhej në fund fare të oborrit të shkollës. Ushtroheshim në vegla dhe bënim stërvitje me qëllim që të dilnim mirë në çdo orë mësimore dhe ishim në garë me njëri-tjetrin dhe e ndihmonim shumë njëri-tjetrin.

Cilat ishin vështirësitë që ndjeve në fillim?

Mësonim rregullisht. Paradite mësim, në drekë pushim një orë dhe pas dite prapë studim. Kjo ishte përditshmëria jonë. Mësuesit ishin nga më të mirët që dilnin nga universiteti, edhe ata më të vjetërit ishin më të përzgjedhurit. Jetonim në konvikt që u bë si shtëpia jonë. Nuk e ndjeva shumë largimin nga familja edhe pse nuk njihja asnjë nga shokët, ishin të gjithë të rinj, kurse në kohën e lirë merreshim shumë me sport dhe koha kalonte. Ne kishim shumë shoqëri, ishin të ardhur nga të gjitha rrethet, shoqëri e pastër pa sherre dhe hatër mbetje, nuk grindeshim. Në shkollë kisha shokë edhe të lagjes. E kishim të mbushur ditën me aktivitet. Studimi zinte pjesën më të mirë dhe ishte thelbësori, por ne nuk kishim problem as për stërvitjen e as për studimet. Palestra jonë ka qenë shumë e mirë, e dyta pas asaj të universitetit. Veglat e hekurit gjithashtu ne i përdornim shumë dhe stërviteshim në to. Midis një studimi dhe tjetrit zinin radhë për të hipur në paralele apo hekurat, bënim rrotullime dhe ushtrime të tjera që na dukeshin shumë sfiduese, e donim dhe e mbronim shumë njëri-tjetrin. Fusha ishte e vogël, por ne na dukej sa e gjithë bota. Në vitet '60-'64, fusha jonë kishte vetëm vegla dhe rërë, stadiumin e bëmë vetë me Kristaq Luarasin pak më vonë, drenazhimin etj. Zhvillonim shumë atletikë dhe në fillim unë dhe të tjerët kemi luajtur me të rinjtë e "Partizanit". Trajneri i ekipit "Partizani" ishte nga Shkolla e Mjeshtërisë Sportive. Shkolla e Mjeshtërisë Sportive ishte shkollë sporti por ne dilnim gjithmonë kampion.

Cilat ishin pasionet e tua, përveç shkollës që ndiqnit?

Unë pasion kam pasur sportin, futbollin, atletikën. Edhe kur isha më herët në Pallatin e Pionierëve, kam

shkuar për fizarmonikë, për kanto, madje më futën të këndoja, por në shkollën "Skënderbej", pasion kisha vetëm sportin. Gjatë rritjes time kam parë se nuk isha për muzikë. Kam pasur shokë që kishin pasione të ndryshme, p.sh Hysni Milloshin e kam pasur shok banke, kishte pasion letërsinë, ai ishte njësh për të shkruar, madje më vonë mbaroi edhe për letërsi, kurse për matematikë, algjebër e trigonometri ishte për "faqe te zeze" (qesh). Por ne i kishim mësuesit jashtëzakonisht të mirë. Zhvillonim matematikë, trigonometri, rusisht gjuhë të huaj, kurse fizika ka qenë lënda që më ka pëlqyer shumë. Kam respekt të veçantë për mësuesit. Kishim grupe me fizarmonikë ose kishte dhe të tjerë që kishin pasion pikurën, aktrimin etj. Gjatë shkollës kishim marrëdhënie me gjimnazet dhe me shkollën pedagogjike dhe zhvillonim aktivitete të përbashkëta, grupe artistike etj.

Pasi mbaruat shkollën "Skënderbej", si vazhduat më tej, çfarë specialiteti ndoqët?

Në 1964 mbarova shkollën "Skënderbej". Ne pasi mbaronim shkollën "Skënderbej" kalonim të gjithë në Shkollën e Bashkuar. Në atë kohë qarkullonte një 'fabul' që në specialitetin gjitharmësh shkojnë nxënës jo dhe aq të mirë në mësim. Por unë mendoj se të jesh me specialitetin "këmbësor" në ushtri je "komandant i përgjithshëm", pasi ti "kërkon llogari", ke aftësinë dhe kontrollin mbi vartësit që janë në artilerinë tokësore, xhenio etj. Edhe pse në atë kohë kishte dalë fjala se te këmbësoria shkonin më të dobëtit, më të papërgatiturit, me ne ndodhi diçka tjetër. Gjeneral Dume, që në atë kohë ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm, e kishte dëgjuar këtë fjalë që qarkullonte, por ndoshta kishte parë edhe gjendjen nëpër reparte dhe si për të ndryshuar këtë mendësi, mori të gjithë kompaninë në rresht dhe i çoi te këmbësoria, donte të ndryshonte mentalitetin e "më të dobëtit" dhe e çoi të gjithë kompaninë tonë për gjitharmësh. Edhe pse për dikë mund të kishte ndërhyrje, ai na çoi të studionim gjitharmësh si kompani.

Çfarë do të kishit zgjedhur nëse do të ishte zgjedhja në dorën tuaj? Kishit mundësi?

Këmbësori. Këmbësori do të ishte edhe zgjedhja ime. U ndanë që ditën e parë kurset ku do të studionim. Dikush, i afërmi im, donte të ndërhynte pranë komandës për të më çuar në kundërajror, por nuk pranova. Donin të më kalonin në artileri, por jo, prapë nuk pranova, zgjedhja së bashku me kompaninë më pëlqeu. Edhe pse zgjedhja për te këmbësoria nuk ishte imja këtë do të zgjidhja edhe sot. Kishte specialitete shumë të mira dhe rezultatet i kisha shumë të mira për të zgjedhur diçka tjetër. Disa nga shokët tanë edhe u ndryshuan degën. Unë nuk kisha vështirësi në studim ose probleme



të tjera familjare dhe dega kishte dhe taktike dhe fizkulturë. Ne si studentë gjitharmësh mësonim nga pistoletat e deri te mitralozit dhe stërvitjet taktike sigurisht. Kam qenë studenti më i mirë në klasë. Isha tip studiues. Nëse shokët mbaronin dhe ikin, unë kisha dëshirë të rrija ende dhe e bëja me sy mbyllur mbërthimin dhe zbërthimin e armës. Kishim armatim të rëndë, zbërthimi dhe mbërthimi me sy mbyllur, ishte objektiv im. Të mbaroje gjitharmësh duhet ta vlerësoje, do të ishte nesër komandant, dhe ti vetë i pari duhet të ishe i zoti.

Si ishte kalimi në një stad tjetër, pasi u diplomuat oficer i ri?

Pasi mbarova shkollën më caktuan pedagog, sepse mbarova me rezultate të shkëlqyera. Por për të thënë të vërtetën unë isha bir punëtori në 1967 dhe më ndërruan me një shokun tim që ishte caktuar në Burrel, për shkak të pozicionit të prindërve të tij. Në vitin 1966-1970 kam punuar si oficer në korpusin e Burrelit, si komandant toge, komandant kompanie, madje edhe si instruktor taktike në shkollën e instrukcionit të korpusit të Burrelit për përgatitjen e kuadrove rezervistë pasuniversitar. Kur shkova në Korpusin e Burrelit, isha 19 vjeç e gjysmë. Detyra e parë që më dhanë ishte Përgjegjës i rinisë, i brigadës së Burrelit. Nuk pranova, iu thashë “a keni ndonjë togë ushtarësh?” Jo se nuk e bëja dot, ishte e lehtë për mua, kisha qenë sekretar rinie dhe isha marrë edhe më përpara, por nuk e pranova këtë detyrë.

Pse? Në atë kohë kishit dhe ato fletërrufetë e famshme...

Jo, jo, nuk kishte fletërrufe në kohën kur unë shkova në Burrel, dolën më vonë ato. Korpusi kishte një kompani ushtarësh që bënte mësim tregues. Kjo kompani zhvillonte gjithmonë mësim tregues në shkollë republike dhe stërvitje taktike edhe me armët e këmbësorisë.

Që nga koha kur nga shkolla “Skënderbej” ndihmuan në hapjen e rrugës në Malësinë e Madhe, te ne u vendos një togë e vazhdueshme, si shkollë instrukcioni e korpusit që përgatiste oficerë për rezervistët, që bënin 6 muaj stërvitje si oficer rezervist, që në situatë lufte do të ishin sipas nevojave që do të kishte komanda apo bateria. Mbi bazën e kësaj u krijua shkolla e instrukcionit e korpusit. Kisha 2 toga, p.sh atje u përgatit dirigjenti Ferdinand Deda dhe artistë të tjerë, ose kitaristi Alfons Balliçi, që kur kalonte me kitarën elektrike i gjithë Burreli e përshëndeste. Ishte një respekt i madh. Çdo të shtunë ose të diel, deri në orën 12, dëgjonin kitarën elektrike në aktiv-

itete të ndryshme të cilat e gjallëronin edhe më shumë jetën atje.

Si ishte dita e parë e punës?

Korpusi ku shkova kishte komandant me kulturë të madhe dhe komisar ishte gjithashtu Halim Ramoditi, që kishte studiuar në BS. Ai ka një kontribut të madh në atë kohë, kur u prishën marrëdhëniet sovjetike pasi ka ndihmuar shumë për të kthyer studentët në atdhe.

Në Burrel u prita shumë mirë, kushtet ishin shumë të mira për ne ushtarakët, ushqimi dhe fjetja gjithashtu, tepër pastërti, por më e rëndësishmja gjeta një ngrohësi familjare. Edhe pse isha mësuar me jetsen time në konvikt dhe larg familjes ajo që gjeta atje ishte vërtet një priturë e ngrohtë familjare. Isha larg familjes, distanca e largët ndjehej, sigurisht, vetëm kur e mendoje se sa larg ishe. Por pastaj ndodhën ngjarje në rajon, situatat e ndryshme si ngjarjet në Kosovë, demonstratat etj.

Si i përjetoni ju ngjarjet në rajon? Sa e ndjeshme bëhej situata edhe për shkak të detyrës? Sa informacion kishit?

Kishim informacion sigurisht. Kur shkova komandant brigade në Burrel, ishte periudhë kërcënuese. Një delegacion shqiptar kishte qenë në Vietnamin e Veriut dhe ishte kthyer. Viti 1967 ishte periudhë kërcënuese. Informacioni ishte se Armatat greke do të dilnin mbi Shkumbin. Na mblodhën në kazermë për stërvitje, oficerë nga më të rinjtë, me qëllim që t'i përballonim situatën. Stërvitjen e drejtoje zëvendësdiri i Zbulimit. Ishin 3 muaj stërvitje. Në Zall Herr na futën tek brigada e tankeve “në prapavijë të forcave të kundërshtarit”. Rinim vetëm me tuta dhe zbatuar. Stërvitjen e bënim zbatuar, që nga maskimi, lëvizjet, gjithçka. Pastaj, vetëm me të brendshme dhe lyeshim me bar dhe baltë, me mjete rrethore për t'u bërë njësh me terrenin, u bëmë si kafshë. 2 muaj e gjysmë stërvitje alpinizëm. Ngjiteshim shkëmbinjve, kapërcenin kodra, me pajime në shpinë. Ishte përvoja që mori delegacioni shqiptar në Vietnam dhe e solli tek ne. Nga koka te këmbët me baltë, orë stërvitje kimie edhe me kundërgaz. Në fund një detashment i zbulimit ishte para nesh, materialet në jug, gati për të vepruar. Në fund 3 kompani zhvilluan mësim tregues nën drejtimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm...

Ishte rrezik real apo thjesht një skenar stërvitje?

Ne ishim në stërvitje. Kundërzbulimi ynë kishte kapur dokumente të Armatës greke, kështu na u transmetua. Agjentët tanë, të dërguar në vendin

fqinj, që vepronin atje që pas çlirimit, njoftonin për një provokacion që ishte më i madhi. Komandanti i Përgjithshëm, Kryeministri, ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, vinin shpesh tek ne edhe në situata normale në shkollë p.sh, kur shpërndareshin diplomat dhe për nxënësit dhe studentët më të mirë ua jepnin ata diplomat. Madje iu bëheshin edhe pyetje dhe kur nuk përgjigjej nxënësi, pyetja pasohej: Kush është pedagogu? Pyeste nxënësin ministri se “si do vepron, nëse ju sulmon një desant?” Pyetjet ishin të ndryshme por konkrete. Asnjë student nuk rrinte pa kaluar në praktikë. Prandaj dhe ajo stërvitje ndoshta ishte një skenar, por ne e morëm si kërcënim real. Por që situata duhej të mbahej ‘tepër sekret’, kështu na u tha. Në përgjithësi çdo informacion ushtarak mbahej sekret edhe nga pjesëtarët e familjes, as nënës as babait, as gruas apo motrës. Madje ka qenë një rast i stërvitjes së shefave të Zbulimit të cilët ishin porositur për ruajtjen e sekretit. Por një shef zbulimi, kur kishte shkuar në familje, mesa duket kishte treguar. Dhe kur një nga eprorët e lartë kishte pyetur granen e tij se nëse dinte gjë se ku bëjnë stërvitjet shefat e zbulimit të ushtrisë, ajo ishte përgjigjur “e di unë”. Në orën 6 na ngrën me komandën “Alarm” në sallën e mbledhjes: “Kush është filani? Ti nuk je zbulues, duhet të largohesh!”. E përjashtuan dhe i hoqën titullin “zbulues”, pra ishte shumë e rëndësishme të ruajë sekretin.

Pasi mbaruam stërvitjen 3 muaj, erdhi dita e mësimt tregues. Në brez lëndë eksplozive, fitila 5 cm të gjatë, lëndë aktive gati për të shpërthyer. Tashmë ishim mësuar se kështu e zhvillonim edhe stërvitjen. Mësimi tregues kishte një kompani të fortifikuar, që ishte baza ku do të sulmonin së bashku me depot e karburantit. Ne kishim bërë edhe më parë stërvitje edhe me brigadën, por kjo stërvitje i vendosi në stërvitje edhe kuadrot kryesorë, batalionin e ruajtjes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe kuadrot si Enver Begeja dhe Rrahman Parllaku. I bënim lëvizjet sipas figuracionit të terrenit, gropave etj., me zvarritje. Unë isha me një detashment prapavije, gjithçka u zhvillua sipas përvojës së marrë në Vietnam dhe në Kinë, pasi ndërkohë ishin prishur marrëdhëniet me rusët. Kjo stërvitje ishte më se e lodhshme, më e fortë, në kufijtë e mbijetesës. Gjithë ditën rrinim zbatuar. Kam bërë shumë stërvitje, por si kjo nuk kishte më parë, jo vetëm që u vendosën të gjithë kuadrot në pikëmbështetje, por ne bënim lëvizje sipas terrenit, 5 m në gjysmë orë, iu afroam afër ushtarëve dhe me fitila e lëndë aktive, që një gabim

i vogël mund të të hidhte në herë. U mësuam, ishte një mbijetesë. Model i mbijetesës... Në fund fare do të lëviznim në det, në lumë për të shkuar tek ura e cila ishte 500 m, në këmbët e së cilës do të vendosnim eksploziv për ta hedhur në erë. Një muaj më parë për këtë na çuan në Tale, duke bërë stërvitje në kanalet e ujërave të zeza me not, ose në këmbë. Dhe mbi kokë mbanim një gjethë që të mos njiheshim, vetëm goja jashtë dhe ajo e mbuluar me gjethë. Komisioni në fund na mori në provim me lëndë eksplozivi.

Çfarë kishte të veçantë?

Me thënë të drejtën e veçanta e asaj stërvitje ishte: as këpucë as atlete, zbatuar.

Pse?

Sepse kështu do të ndodhte në luftë, do të të prisheshin këpucët dhe do të mbeteshe zbatuar. Kishim trajner për alpinizëm si dhe trajnerë të përgatitjes fizike. Lëviznim nga një kodër tek tjetra me teleferik. U mësuam dhe u përgatitem kaq shumë nëpër pjerrësi sa nuk mund të imagjinohet. Kërcënim i ishte real sipas dokumenteve që kishin kapur zbuluesit tanë, për provokacionin grek, të cilët do të vinin mbi Shkumbin.

Si e përballuat?

Si të mos e përballoje, ishin 3 muaj stërvitje, që kishim imituar kafshët. Nuk kishte turp më të madh dhe tronditje më të madhe, p.sh si rasti kur erdhi gjenerali dhe i tha zbuluesit, “Nuk je zbulues!”. Ishte një stërvitje rraskapitëse, por që ia vlejti.

Kur mendon se Shkolla e Bashkuar ka pasur periudhën e saj më të ndritur?

Deri në '90-ën gjithçka ka ardhur duke u rritur, gjithçka në progres.

Si ndodhi që u rikthyet dhe erdhët pedagog në Tiranë?

Gjatë viteve 1970-1980 kam punuar si pedagog taktike dhe taktiko-zbulimi në fakultetin gjitharmësh të Shkollës të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Kishte nevojë për pedagogë. Ndërkohë emërimin e kisha ende në Burrel. Në fund komandat Enver Begeja na mblodhi në pedagogë, ndoshta edhe prej kushteve sociale që ishin atëherë, siç ishte stërvitja p.sh, pasi unë në atë kohë mund të jetoja në shtëpinë e prindërve. Kjo përveç eksperiencës më ndihmoi që të filloja punë si pedagog. Më vonë gjatë kësaj kohe, në vitin 1976, krijova familjen time, për të cilën jam shumë krenar. Gjithmonë i kam motivuar fëmijët e mi për t'u realizuar në jetën e tyre, ashtu si babai im më motivoi mua për të ecur në rrugën time, duke kursyer për ne fëmijët e tij gjithçka. Kam punuar me kontribut vullnetar gjithashtu për të mundësuar stërvitjen

për familjen time të re. Janë bërë disa pallate me kontribut vullnetar atëherë dhe pushimin e shfrytëzoja për të shkuar në punën vullnetare. Babai im ishte një murator me emër dhe specialist i mirë në ndërtim, kështu që nuk i përtoja punës edhe për traditë.

Pas mbarimit të Akademitë së Shtabit të Përgjithshëm, ju u emëruat prapë në Burrel, si ishte të iknit sërish nga Tirana?

Po, në vitin 1980-1982 kam mbaruar Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm me rezultate të shkëlqyera. Njihja specialitetin tim, si gjitharmësh dhe komandat e korpuseve dhe brigadave sipas planit dërgonin oficerët për studime në akademi. Ishte i vetmi kurs që filloi atëherë. Mbarova shkëlqyeshëm, ashtu si të gjitha shkollimet. Daja im, ish-partizan, megjithatë nuk ishte dakord që unë të shkoja aq larg, sërish në Burrel, sepse isha dhe djali i madh i familjes dhe kjo edhe ngaqë të dy dajat dhe nëna ime ishin rritur jetimë. Ne në korpus kishim autonome në Burrel, por nuk u emërova atje, nuk kishte lidhje dega që kishe për t'u emëruar, s'kishte lidhje se si kishe mbaruar me rezultatet. Madje daja me tha të më ndërhynte tek emërimet, madje më propozoi që të lija shkollën dhe të nisja nga e para ekonomikun, por unë e doja profesionin tim dhe të mirat që më sillte ky profesion. Në fillim shkova nga ana ekonomike, por të mirat që më jepte dhe fakti që kisha dalë tashmë me rrogë, paga ime ishte e mirë dhe kisha pushime të garantuara, krahasuar me kuadrot e tjerë. Mezi kisha pritur që të dilja në jetë, por edhe me vështirësitë e profesionit kurrën e kurrës nuk u pendova.

Pastaj, në vitin 1982, për 6 muaj kam punuar si shef Shtabi në Brigadën e Këmbësorisë, në repartin 1045, në Korpusin e Burrelit. Për mua kishte ndryshur struktura e përgatitjes. Tashmë isha një stad më lart. Jo vetëm në kuptimin figurativ, por vartësit e mi “do të dridheshin” për sa i përket metodikave sepse tashmë isha më i specializuar, pasi ishte një kurs më i avancuar. Pastaj më vonë, në vitin 1982-1992 kam punuar si komandant Brigade të Këmbësorisë, në repartin 2166, në Bulqizë, në Divizionin e Këmbësorisë së Burrelit me gradën e “kolonelit”.

Si vazhdoi më vonë?

Ishte viti 1993, kur punova komandant në Shkollën e Lirë Ushtarake në Sauk, në brigadën e këmbësorisë të Selitës dhe shef Shtabi i Brigadës Vullnetare në Tiranë, me forcat vullnetare tek sheshi “Avni Rustemi”. Por ky do të ishte dhe një vit tepër i vështirë dhe i dhimbshëm për mua si për shumë ish-ushtarakë të tjerë, pasi në dhjetor 1993, në kulmin e moshës, isha vetëm 47 vjeç, kur me urdhrin 24/1 më nxorën në lirim me gradën e “kolonelit”. Këtu përfundoi edhe jeta ime si një ushtarak aktiv, një jetë e mbushur plot me sfida dhe sakrificat personale dhe familjare, që nuk do të shlyhen dhe harrohen kurrë.

Vitet kalojnë dhe unë si shumë bashkëoficerë kam aderuar në shoqatën e ish-ushtarakëve dhe kemi kryer disa aktivitete brenda dhe jashtë vendit. Por tashmë këto shoqata janë disa, po kështu edhe shoqata të ish-skënderbegasve. Më shpesh ne mblidhemi si shokë të ish-kompanisë, organizojmë takime të herë pas hershme dhe flasim ende për FA-të, sigurisht dhe njihemi me informacionet më të reja ushtarake. FA-të kanë ndryshuar shumë. Sot ato janë pjesë e NATO-s dhe ne ndjehemi krenarë me arritjet e ushtrisë sonë sot. Ndjehemi po aq krenarë që kemi kontribuar dhe vënë një gur të rëndësishëm në historinë e Ushtrisë shqiptare, në rrugën nëpër të cilën ajo kaloi.

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Forca e Reagimit të NATO-s, demonstrimi i kohezionit dhe angazhimit aleat

Germania do të ketë gjatë vitit 2023 drejtimin e forcës ushtarake të gatishmërisë më të lartë të NATO-s, VJTF, duke vendosur mijëra trupa në gatishmëri dhe gati për t'u vendosur brenda disa ditësh. Gjermania mori drejtimin më 1 janar 2023 nga Franca, e cila udhëhoqi forcën në vitin 2022.

Forca e Reagimit të NATO-s është një forcë shumëkombëshe shumë e gatshme dhe e avancuar e përbërë nga komponentë tokësorë, ajrorë, detarë dhe të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF) që Aleanca mund t'i vendosë shpejt, kudo që të jetë e nevojshme. Përveç rolit të saj operacional, NRF mund të përdoret për bashkëpunim më të madh në arsim dhe trajnim, rritje të ushtrimeve, mbështetje për lehtësimin e fatkeqësive dhe përdorim më të mirë të teknologjisë. Ajo është në gjendje të ofrojë një përgjigje të shpejtë ushtarake ndaj një krize në zhvillim, qoftë për qëllime të mbrojtjes kolektive ose për operacione të tjera të reagimit ndaj krizave. NRF i jep Aleancës mjetet për t'iu përgjigjur me shpejtësi llojeve të ndryshme të krizave kudo në botë. Ajo është gjithashtu një motor shtytës për transformimin ushtarak të NATO-s.

NRF bazohet në një sistem rrotullues ku vendet aleate angazhojnë njësi tokësore, ajrore, detare ose të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF) për një periudhë prej 12 muajsh. NRF është gjithashtu e hapur për vendet partnere, pasi të miratohet nga Këshilli i Atlantikut të Veriut. Pjesëmarrjes në NRF i paraprin përgatitja kombëtare, e ndjekur nga trajnimi me pjesëmarrës të tjerë në forcën shumëkombëshe. Ndërsa njësitë rrotullohen përmes NRF-së, standardet, konceptet dhe teknologjitë e larta të lidhura shpërndahen gradualisht në të gjithë Aleancën, duke përmbytur kështu një nga qëllimet kryesore të Forcës së Reagimit të NATO-s – transformimin e mëtejshëm të forcave aleate. Komanda operationale e NRF alternohet çdo vit midis Komandave të Forcave të Përbashkëta Aleate në Brunssum, Holandë dhe Napoli, Itali.

NRF si një forcë e fuqishme, çfarë përfshin?

Aleatët e NATO-s vendosën në Samitin e Uellsit të vitit 2014 të përmirësojnë NRF-në duke krijuar një "forcë majë shtize" brenda saj, të njohur si Task Forca e Përbashkët e Gatishmërisë Shumë të Lartë ose VJTF. Kjo NRF e zgjeruar është një nga masat e Planit të Veprimit të Gatishmërisë (RAP) i rënë dakord nga aleatët për t'iu përgjigjur ndryshimeve në mjedisin e sigurisë. Forca e zgjeruar e reagimit të NATO-s përfshin elementin bazë të komandimit dhe kontrollit dhe Komanda operationale e NRF-së alternohet ndërmjet Komandave të Forcave të Përbashkëta Aleate në Brunssum dhe Napoli. Përfshin Task Forcën e Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë (VJTF), që ky element i NRF ka rreth 20 000 trupa, me një brigadë tokësore shumëkombëshe prej rreth 5 000 trupash dhe komponentë ajrorë, detarë dhe SOF. Elementët kryesorë janë gati të lëvizin brenda dy deri në tre ditë. Aleatët marrin rolin kryesor për VJTF-në në bazë të rotacionit. Përfshihet gjithashtu Grupi Fillestar i Forcave Ndjekëse (IFFG), që këto janë forca të gatishmërisë së lartë që mund të vendosen shpejt pas VJTF-së, në përgjigje të një krize. Ato përbëhen nga dy brigada shumëkombëshe, një komponent detar që bazohet në Grupet e Përhershme Detare të NATO-s (SNMG) dhe Grupet e Përhershme të Kundërmasave të Minave të NATO-s (SNMCMGs), si dhe një komponent të mbështetjes ajrore si dhe ajrore luftarake. Përfshin gjithashtu edhe Forcat e Operacioneve Speciale dhe një grup



pune për mbrojtjen kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN).

Përpara përdorimit, NRF përshtatet (i rregulluar në madhësi dhe aftësi) për t'iu përshtatur kërkesave të çdo operacioni specifik për të cilin është angazhuar. VJTF dhe Forcat Fillestare Ndjekëse janë të vendosura në vendet e tyre të origjinës, por janë në gjendje të vendosen kudo që nevojiten për stërvitje, reagim ndaj krizave ose mbrojtje kolektive. VJTF mori pjesë në stërvitjen e saj të parë të dislokimit në Poloni në qershor 2015 dhe testohet rregullisht gjatë ushtrimeve mbi aftësinë e saj për t'iu vendosur dhe për t'iu përgjigjur çdo krize që lind. Udhëheqja e VJTF-së rrotullohet çdo vit, (konkretisht Gjermania 2023) me një aleat të caktuar si vendi kryesor dhe aleatë të tjerë pjesëmarrës. Në total, NRF e zgjeruar përfshin rreth 40 000 trupa.

Në çdo mision dhe kudo, NRF në lehtësimin e fatkeqësive

NRF ofron një demonstrim të prekshëm të kohezionit dhe angazhimit të NATO-s për parandalimin dhe mbrojtjen kolektive. Çdo rotacion NRF duhet të përgatitet për një gamë të gjerë detyrash. Këto përfshijnë kontributin në ruajtjen e integritetit territorial, demonstrimin e forcës, operacionet e mbështetjes së paqes, lehtësimin e fatkeqësive, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe operacionet e sigurisë. Operacionet e hyrjes fillestare kryhen së bashku si pjesë e një force më të madhe për të lehtësuar ardhjen e trupave pasuese. Elementet e NRF ndihmuan në mbrojtjen e Lojërave Olimpikë Verore 2004 në Athinë, Greqi, dhe u vendosën për të mbështetur zgjedhjet presidenciale afgane në shtator të të njëjtit vit. NRF është përdorur gjithashtu në lehtësimin e fatkeqësive. Në shtator dhe tetor të vitit 2005, avionët nga NRF dërguan ndihma të dhuruara nga vendet anëtare dhe partnere të NATO-s në Shtetet e Bashkuara për të ndihmuar në trajtimin e pasojave të uraganit Katrina. Nga tetori 2005 deri në shkurt 2006, elementët të NRF-së u përdorën në përpjekjet e ndihmës ndaj fatkeqësive në Pakistan, pas tërmetit shkatërrues të 8 tetorit. Avionët nga NRF u përdorën në një urë ajrore që dërgoi pothuajse 3 500 ton furnizime të nevojshme urgjentisht në Pakistan, ndërsa inxhinierët dhe personeli mjekësor nga NRF u vendosën në vend për të ndihmuar në përpjekjet e ndihmës. Elementet e NRF u aktivizuan në gusht 2021 për të mbështetur evakuimin dhe zhvendosjen e afganëve që punonin për krah NATO-s, së bashku me familjet

e tyre. Kjo përgjigje përfshinte krijimin e "Task Force Noble", një task forcë që koordinon qindra trupa të NRF nga 20 vende aleate. Këto trupa po mbështesin evakuimin në vende në të gjithë Evropën, duke përfshirë avionët e transportit, pajisjet e ndërtimit, ambulancat, ekipet mjekësore, ekipet e çështjeve civile dhe personelin e sigurisë.

Në përgjigje të pushtimit brutal dhe të paprovokuar të Rusisë në Ukrainë në shkurt 2022, NATO vendosi elementët të gatishmërisë së lartë të NRF për herë të parë në një rol parandalues dhe mbrojtës. Aleatët kanë vendosur mijëra trupa shtesë, së bashku me automjete të blinduara, njësi artilerie, anije dhe avionë, në gatishmëri të lartë të destinuara për NRF, duke siguruar që ajo të vazhdojë të ketë shpejtësinë, reagimin dhe aftësinë për të mbrojtur territorin dhe popullsinë e NATO-s.

Si filloi nisma e Forcave të Reagimit të NATO-s dhe si evolui

Nisma e Forcave të Reagimit të NATO-s u njoftua në Samitin e Pragës në nëntor 2002. Sipas fjalëve të gjeneralit James Jones, atëherë Komandanti Suprem i Aleatëve të NATO-s në Evropë (SACEUR), "NATO nuk do të ketë më njësitë e mëdha dhe masive që ishin të nevojshme për Luftën e Ftohtë, por do të ketë forca të shkathëta dhe të afta në nivelet e gatishmërisë së diplomuar që do ta përgatisë më mirë Aleancën për të përballuar çdo kërcënim që ka të ngjarë të përballet në këtë shekull të 21-të." Koncepti i NRF u miratua nga ministrat e Mbrojtjes të Aleatëve, në qershor 2003, në Bruksel. Në tetor 2004, në një takim jozyrtar të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s në Poiana Brasov, Rumani, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe SACEUR njoftuan zyrtarisht se NRF kishte arritur aftësinë e saj fillestare operationale dhe ishte gati të merrte përsipër gamën e plotë të misioneve. Në qershor 2006, aftësitë e NRF u testuan në një stërvitje të madhe të drejtpërdrejtë, "Steadfast Jaguar 06", në ishujt Cape Verde. Vendndodhja sfiduese u projektua posaçërisht për të demonstruar dhe provuar qëndrueshmërinë e konceptit NRF dhe në Samitin e Rigës të NATO-s në nëntor 2006, NRF u deklarua plotësisht e gatshme për të ndërmarrë operacione. Mënyra e krijimit dhe e përbërjes së NRF-së është përshtatur dy herë, në 2008 dhe 2010. Kjo ishte për të ofruar një qasje më fleksibël për gjenerimin e forcës, duke lehtësuar kështu kontributet e forcës, të cilat po pengoheshin nga ritmi i qëndrueshëm i lartë operacional

që lindte nga Afganistani. Iraku dhe misionet e tjera. Për të mbështetur më tej gjenerimin e forcës, aleatët i kanë vendosur vetes objektiva kombëtare vullnetare për kontributet e forcës. Më 21 shkurt 2013, u ra dakord që NRF do të ishte në thelb të Iniciativës së Forcave të Lidhura me qëllim ruajtjen e gatishmërisë dhe efektivitetit luftarak të NATO-s. Në Samitin e Uellsit, në shtator 2014, u vendos të përmirësohen NRF-të dhe të krijohet Task Forca e Përbashkët e Gatishmërisë Shumë të Lartë (VJTF), dhe të zhvillohej një stërvitje shumëkombëshe, me shikueshmëri të lartë, "Trident Juncture 2015", të organizuar nga Italia, Portugalia dhe Spanja. Gjithashtu, në vitin 2016 filloi një program ushtrimesh më i gjerë dhe më kërkues, me NRF-në si element kyç në ushtrime. Më 5 shkurt 2015 u vendos që VJTF do të përbëhej nga një komponent tokësor prej rreth 5 000 trupash me njësi të përshtatshme ajrore, detare dhe SOF në dispozicion. Franca, Gjermania, Italia, Polonia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar ranë dakord të marrin rolet kryesore për VJTF-në me rotacion. U ra dakord gjithashtu që VJTF do të ishte e aftë operacionalisht deri në Samitin e Varshavës 2016, një synim që u arrit. Më 9 qershor 2015, VJTF u vendos për herë të parë në Poloni gjatë stërvitjes "Noble Jump", ku morën pjesë mbi 2 100 trupa nga nëntë vende të NATO-s. Kurse në qershor 2015, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s morën vendime për komponentët ajror, detar dhe SOF të NRF-së së zgjeruar, që ajo mund të përbëhet nga deri në 40 000 personel. Ata morën më tej masa për të përshtatur vendimmarrjen politike dhe ushtarake, përfshirë autoritetin për Komandantin Suprem të Aleatëve të NATO-s në Evropë për të përgatitur trupat për veprim sapo të merrret vendimi politik. U miratua gjithashtu një mjet i ri planifikimi paraprak, Planet e Reagimit të Diplomuar, duke mundësuar që planet e operacioneve të ekzekutueshme të gjenerohen jashtëzakonisht shpejt, në përpjesëtim me kërkesat e gatishmërisë së forcave. Ministrat ranë dakord edhe për krijimin e një shtabi të ri të përhershëm të grupit të mbështetjes logjistike të përbashkët brenda Strukturës së Komandës së NATO-s. Në tetor 2015, iu dha drita jeshile konceptit të plotë ushtarak për Forcën e Përpunuar të Reagimit të NATO-s, duke përfshirë aranzhimet e komandës dhe kontrollit të saj. Gjatë stërvitjes "Trident Juncture" në fund të vitit 2015, VJTF u testua dhe u certifikua për vitin 2016. Stërvitja gjithashtu

certifikoi selinë e NRF për 2016, JFC Brunssum.

Më 10 shkurt 2016, u deklarua aftësia fillestare operationale (IOC) për iniciativën e Përbashkët të Inteligjencës, Mbikëqyrjes dhe Zbulimit (JISR) të NATO-s. Ky IOC përqendrohet në rritjen e ndërgjegjësimit për situatën e Forcës së Reagimit të NATO-s përmes aftësive të rritura në mbledhjen, përpunimin dhe shkëmbimin e inteligjencës. Ndërsa në Samitin e Varshavës, më 9 korrik 2016, liderët aleatë mirëpritën zbatimin e Planit të Veprimit të Gatishmërisë (RAP) dhe, nëpërmjet masave të tij afatgjata të përshtatjes, përmirësimin e NRF dhe një Task Force të re të Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë (VJTF), në gjendje të fillojë vendosjen brenda dy deri në tre ditë. Gjatë stërvitjes "Trident Juncture 18", të mbajtur në Norvegji nga 25 tetor deri më 7 nëntor 2018, VJTF u testua dhe stërvitja certifikoi brigadën gjermane, Panzerlehr e 9-të, për 2019. Stërvitja përfshiu rreth 51 000 personel nga vendet anëtare dhe partnere, përfshirë gjashtë brigadat e ushtrisë dhe Forcat Tokësore të mbështetura nga njësitë ajrore, detare dhe të Forcave të Operacioneve Speciale. Ajo u fokusua kryesisht në aftësinë e NATO-s për të lëvizur shpejt personelin dhe armaturën nëpër Evropë. Gjatë stërvitjes "Noble Jump II 21" (19 maj - 1 qershor 2021), elementët tokësorë të VJTF u vendosën në Rumani. U përfshinë rreth 4 000 trupa nga 12 vende. Divizioni Shumëkombësh Juglindor i Shtabit dhe Njësia e Integritetit të Forcave të NATO-s e lehtësuan këtë dislokim. Për më tepër, stërvitja kryesore e përbashkët e NATO-s, "Steadfast Defender 21" (20 maj - 22 qershor) u fokusua në përforsimin e VJTF-së përtej Atlantikut dhe në të gjithë Evropën.

Në qershor 2021, u ra dakord për të forcuar dhe modernizuar më tej Strukturën e Forcave të NATO-s, e cila përfshiu ndryshime në NRF dhe në gusht 2021, elementët të NRF u aktivizuan për të mbështetur evakuimin dhe zhvendosjen e afganëve që punonin së bashku me NATO-n dhe familjet e tyre. Kurse në shkurt 2022, në përgjigje të pushtimit brutal të Ukrainës nga Rusia, NATO aktivizoi elementët të gatishmërisë së lartë të NRF për herë të parë në një rol parandalues dhe mbrojtës. Gjithashtu në shkurt 2022, si pjesë e punës së vazhdueshme për forcimin dhe modernizimin e Strukturës së Forcave të NATO-s, aleatët ranë dakord për një model të ri force. Në qershor 2022, aleatët ranë dakord të zbatonin modelin e ri të forcës, që vazhdon ende. NRF do të vazhdojë të gjenerohet paralelisht me forcë derisa modeli i ri i forcës të zbatohet plotësisht. Në mars dhe prill 2022, elementët të Forcës së Reagimit të NATO-s morën pjesë në stërvitjen "Cold Response 2022" në Norvegji, e cila mblodhi së bashku mbi 30 000 trupa nga 27 vende. Stërvitja testoi aftësinë e NRF për të përforsuar Norvegjinë dhe për t'iu integruar me forcat e armatosura të aleatëve dhe partnerëve të tjerë për të mbrojtur territorin e NATO-s. E ndërsa në qershor 2006, aftësitë e NRF u testuan në një stërvitje të madhe të drejtpërdrejtë, Steadfast Jaguar 06, në ishujt Cape Verde. Vendndodhja sfiduese u projektua posaçërisht për të demonstruar dhe provuar qëndrueshmërinë e konceptit NRF. Në Samitin e Rigës të NATO-s në nëntor 2006, NRF u deklarua plotësisht e gatshme për të ndërmarrë operacione.

PËRFSHIRJA DHE PJESËMARRJA E TË RINJVE, SI DIMENSIONI KYÇ I NDËRTIMIT DHE MBAJTJES SË PAQES DHE SIGURISË

Rinia, paqja dhe siguria, pse duhet të kujdesemi?

Brezi i sotëm i të rinjve është më i madhi që bota ka njohur ndonjëherë, dhe të rejtat dhe të rinjtë shpesh përbëjnë shumicën e popullsisë në vendet e prekura nga dhuna dhe konfliktet e armatosura. Prandaj, kontributi i tyre në siguri është thelbësor.

Axhenda e Rinisë, Paqes dhe Sigurisë (YPS) e krijuar nga Rezoluta 2250 (2015) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe rezolutat pasuese 2419 (2018) dhe Rezoluta 2535 (2020), njeh përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve si dimension i kyç i ndërtimit dhe mbajtjes së paqes dhe sigurisë për të gjithë. Rezoluta identifikon pesë shtylla për veprim si:

Pjesëmarrja, që merr parasysh pjesëmarrjen dhe pikëpamjet e të rinjve në proceset vendimmarrëse, nga negociatat dhe parandalimi i dhunës deri te marrëveshjet e paqes;

Mbrojtja, sigurimi i mbrojtjes së jetës së civilëve të rinj dhe të drejtave të njeriut dhe hetimi dhe ndjekja penale e atyre që janë përgjegjës për krimet e kryera kundër tyre;

Parandalimi, mbështet të rinjtë në parandalimin e dhunës dhe në promovimin e kulturës së tolerancës dhe dialogut ndërkulturor;

Partneriteti, angazhon të rinjtë gjatë dhe pas konfliktit gjatë zhvillimit të strategjive të ndërtimit të paqes së bashku me aktorët e komunitetit dhe organet e Kombeve të Bashkuara;

Shkëputja dhe riintegrimi, që do të thotë investimi në të rinjtë e prekur nga konflikti i armatosur përmes mundësive të punësimit, politikave gjithëpërfshirëse të punës dhe edukimit që promovon një kulturë paqeje, siç tregohet në Koalicioni Global për Rininë, Paqen dhe Sigurinë (2022) "Zbatimi i agjendës për të rinjtë, paqen dhe sigurinë në nivel vendi: Një udhëzues për zyrtarët publikë". Përmes integritit kuptimplotë të të rinjve në përpjekjet për paqe, institucionet do të njohin kontributin e tyre në të tashmen



dhe në të ardhmen. Të rinjtë kryejnë punë të rëndësishme për ndërtimin e paqes, duke përfshirë kontaktin me bashkëmoshatarët, punën në nivel komuniteti, ruajtjen e dialogut dhe tejkalimin e ndarjeve në kontekste të polarizuara.

Kur të rinjve u jepet mundësia për të marrë pjesë në proceset e paqes, ata fitojnë aftësi qytetare dhe shpesh bëjnë angazhime të përjetshme për paqen. Prandaj kjo është edhe një investim në të ardhmen.

Puna e NATO-s me të rinjtë

NATO angazhohet me të rinjtë në disa nivele të ndryshme dhe përmes qasjeve të ndryshme. Aleanca mund të përfitojë dhe të mësojë nga perspektiva të reja, dhe në të njëjtën kohë t'u japë të rinjve mundësi për t'u përfshirë dhe për t'u dëgjuar. Programi i NATO-s Shkenca për



Paqe dhe Siguri, për shembull, po zhvillon gjithnjë e më shumë projekte që ofrojnë mundësi dhe bursa për të mbështetur dhe përfshirë shkencëtarët e rinj në fazat e hershme të karrierës së tyre.

Për më tepër, si pjesë e nismës NATO 2030, NATO është angazhuar me liderë të rinj për të fituar kontributin e tyre se si të forcohet më tej Aleanca për të përballuar sfidat e reja të sigurisë të dekadës së ardhshme. Grupi i Udhëheqësve të Rinj të NATO-s 2030, i cili u shpall në Samitin e Rinisë së NATO-s 2030, përbëhet nga 14 liderë në zhvillim nga e gjithë Aleanca, të cilët u zgjodhën nga programe të shquara të liderimit me të rinj. Ata përfaqësojnë fusha të ndryshme profesionale, nga studiuesit tek inxhinierët e hapësirës dhe diplomatët. Më 4 shkurt 2021, Udhëheqësit e Rinj të NATO-s 2030 i paraqitën një raport Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, me këshilla se si të bëhet NATO një Aleancë edhe më e fortë.

Një tjetër projekt i madh është Samiti vjetor i Rinisë së NATO-s. Samiti më i fundit i Rinisë së NATO-s u zhvillua më 28 prill 2022. Ai kishte titullin "Sigurimi i së ardhmes sonë të përbashkët" dhe u organizua në bash-

këpunim me Qendrën për Analizën e Politikave Evropiane (CEPA). Diskutimet e panelit të Samitit të Rinisë mbuluan sfidat urgjente të sigurisë, duke përfshirë ndryshimet klimatike, dezinformimin, krizat humanitare, teknologjitë në zhvillim dhe diskriminimin gjinor. Këta janë vetëm disa shembuj, por ka shumë më tepër mënyra në të cilat NATO ndërvepron me të rinjtë dhe inkurajon pjesëmarrjen e tyre në të gjitha aspektet e mbrojtjes, paqes dhe sigurisë.

E ardhmja është femra dhe të rinjtë

Po si përshtaten së bashku Axhenda e Grave, Paqes dhe Sigurisë (WPS) dhe YPS? Axhendat e WPS dhe YPS janë të ndërlidhura dhe plotësuese. Që të dyja axhendat mbrojnë grupet që historikisht janë përjashtuar nga

proceset vendimmarrëse. Kontributet e të dy grupeve bazohen në përvojat dhe njohuritë që shkojnë shumë përtej mjediseve tradicionale të konfliktit, por gjithashtu përfshijnë forma të ndryshme të përjashtimit dhe diskriminimit, krimin të organizuar dhe dhunës seksuale dhe të bazuar në gjini. Këto forma të ndryshme të dhunës janë shumë gjinore, ku gratë e reja janë veçanërisht të ndjeshme ndaj përjetimit të dhunës në familje, sulmeve seksuale, rrëmbimit, trafikimit, torturës dhe punës së detyruar dhe formave të tjera të dhunës. Megjithatë, njohja e komplementaritetit midis agjendave të WPS dhe YPS nuk do të thotë se dy grupet e grave dhe të rinjve, janë një. Kjo do të mohonte nevojat dhe sfidat specifike të secilit prej këtyre grupeve. Në vend të kësaj, politikëbërësit dhe praktikuesit duhet të marrin një qasje ndërsektoriale që siguron që të gjitha politikat, programet dhe iniciativat të kapin plotësisht dinamikat e pushtetit të bazuara në moshën dhe gjininë.



Verdi Take: Skënderbegas, ju na deshët dhe ne ju donim me shpirt!

Verdi Take, ishte një prej edukatorëve të dashur skënderbegas, intelektual i cili ka lënë gjurmë në punën e tij si krijues e regjisor, si në këtë shkollë, ashtu dhe në shumë skena teatrosh të vendit. Një meritë e veçantë e tij është puna e palodhur në gjetjen e elementeve dhe zhvillimin e aktiviteteve të shumta kulturore e artistike në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” dhe Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” në Tiranë...

Verdi Take u lind në qytetin e Korçës, më 3 gusht 1938. Në vitin 1961 ka mbaruar shkollën ushtarake në Tiranë dhe është diplomuar oficer. Në vitet 1963-1965, ka qenë komandant toge në shkollën “Skënderbej”, ku ka meritën e ngritjes së grupit artistik të estradës, i cili fitoi vendin e parë në Festivalin e Estradave amatore të Ushtrisë (viti 1965). Në atë shfaqje, toger Verdi Take ishte autor i libretit, regjisor dhe konferencier... Me krijimtari letrare, Verdi Take është marrë që në rininë e tij. Ka botuar qindra artikuj publicistik, kryesisht në shtypin ushtarak, ka shkruar pjesë humoristike që janë vënë në skenë nga trupa amatore e profesioniste. Autorësinë e tij e gjen edhe në dhjetëra filma dokumentarë,

herë si skenarist, herë si regjisor, autor tekste etj. Ka qenë shef i Sektorit Kinematografik të Ushtrisë pranë Kinostudios “Shqipëria e Re”, shef i Estradës Profesionale të Ushtrisë, shef i Qendrës së Foto-Filmit të ushtrisë dhe regjisor në disa pallate kulture. Ka botuar tri libra me tematikë nga jeta në ushtri. Në konkurset letrare kombëtare, ka fituar dy herë çmime. Një nga filmat e tij dokumentarë, si “Do të kthehem përsëri”, me tematikë nga ngjarjet tragjike të ushtrisë në vitin 1977, u paraqit në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Ushtarak, në Rumani, i cili u nderua me “Çmimi i Veçantë”. Në vitin 1997, Verdi Take doli në pension. Gjatë viteve të pensionit është aktivizuar me ndihmesën artistike në shkollat të mesme të qytetit të Tiranës. Për këtë është vlerësuar me çmime kombëtare “Mirënjohje”. Një kontribut të vyer ka dhënë me pjesëmarrjen në disa televizione, ku është ftuar për të folur për problemet e humorit, për promovimin e filmave të tij dokumentarë dhe tema të tjera shoqërore. Në nëntor të vitit 2017, si skenarist e si regjisor, realizoi filmin dokumentar mbi veprimtarinë e gjeneralmajor Qazim Kapisyzit, film i cili, me kujdesin e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, u shfaq në Muzeun Historik Kombëtar

Profesor Verdi në librin historik “Skënderbegasit ndër vite” do të shkruante:

Më kujtohen në ato vite... Na kishin si prindër, sepse edhe ne, komandantët e tyre, silleshim si prindër me ta. Po tregoj, më poshtë, vetëm një ngjarje, nga dhjetëra që kam në kujtimet e mia.

Nga Shkolla e Bashkuar e Ofi-



cerëve, më transferuan në shkollën “Skënderbej”, sepse komandanti i asaj shkolle, do të më jepte detyrën e shefit të Klubit të Kulturës. Por, fillimisht, sa të lirohej vendi, më caktoi komandant toge. Unë, të them të drejtën, u mërzi disa, sepse pasioni im ishte puna artistike. Por më e keqja ishte se, në togën ku më caktoan, kishte një problem: Atë e influenconte jo zëvendës komandanti, por njëri nga nxënësit. Ai quhej Frederik Shqera. Çfarë të thoshte ai, bënte e gjithë toga. Ti udhëhiqte për mirë, hajde de, por ai shkonte kundër “rrymës”. I fola dhe i tërhoqa vëmendjen disa herë, por ai as që pyeste për mua. “Si t’ia bëj këtë “shqerës” që po më bëhet si “ujk” në toge”, mendoja i shqetësuar. Dhe, një natë, kur isha oficer roje, me ‘zyrë’ te cepi i derës së hyrjes së shkollës, (në ju kujtohet), në orën një të natës, u ngjita në fjetore dhe, duke ecur shumë ngadalë, shkova te krevati i Fredit. Ai flinte poshtë. Ishte fund vjeshte. Moti ishte ftohur. Binte dhe një shi i hollë. Kishte rënë përmbys sikur bënte not. Ia largova batanijen dhe i thashë me zë të ulët por të prerë:

- Çohu!
- Çfarë?
- Çohu, të thashë, vishu!
- Ça ke mo, toger?
- Sh, sh, sh...! Vishu dhe hajde me mua.

Kështu, tërë inat, duke më hedhur herë pas here nga një vështrim prerazi, u ngrit.

- Ee! - më tha ai, duke bërë me kokë.

Hem, thashë me vete, “ec, ec” se ta rregulloj unë ty, sonte në këtë natë..., në orën një të saj.

Arritëm te zyra e oficerit të rojës. Kur futa çelësin për ta hapur, po më dridheshin duart! Nuk e di, ishte inati, apo më shqetësonte diçka tjetër...!

- Fol një cikë shpejt, se du me shku me fjetje..., - më urdhëroi ai duke më parë drejt e në sy. Ai shikim, iu shtua atij merakut që pata kur mundohesha të hapja derën. Frederiku - shokët e tij duhet ta kujtojnë - ishte i fuqishëm, me një trup të bëshëm...

Ai po dridhej nga pak. Nuk e kishte nga e ftohta se sa nga inati. Unë e dija këtë dhe qëndrova vigjilent... “Hej drejt, -mendova, - kujdes Verdo se po u egërsua ky “shqera-dash”, mund të hash ndonjë bri që të fluturosh jashtë dritares”. Në rininë time, kam qenë i dobët në shëndet, i gjatë, i hollë me shumë se duhej... Ju kujtohem, besoj.

Me vete kisha një palë dorashka meshini, të zeza, që kishin një tokëz metalike, të verdhë, për t’u mbërthyer te kyçi i dorës. I nxora, me një lëvizje artistike dhe, u ula mbi tavolinë, duke tundur ritmikisht këmbën me çizme, që varej teposhtë.

- Hë skënderbegas Shqera (e theksova si me ironi)! Ai ngriti kokën, më nguli sytë dhe nuk foli.

- Hë mo, fol! Pse sillesh kështu ti?
- Si sillem, o shoku toger?

- Sillesh...ja...ashtu...ma bën togën çorap!

- Pse, ç’a i boj togës, unë?

Vetëtimthi e godita me dorashkën që tundja në duar. Ai u mbush me frymë, bëri vetëm 10 centimetra drejt meje, kurse unë zbrita nga tavolina... dhe peshova fort mbi dy këmbët. E qëllova përsëri, me tepër për të fituar superioritet. Tokëza e dorashkës e zuri

në buzën e sipërme, mbi të cilën u shfaq një bulzë gjaku, i kuq. Ai e ndjeu, i fryu që të mos i rridhte në gojë dhe, pastaj e fshiu me buzën e poshtme.

Në një të qindtën e sekondës, u rrotullova prapa tavolinës dhe, po aq vetëtimthi, u kujtova se pas shpine s’ kisha dritaren...

Për fat, ai u mjaftua vetëm me atë shikim të paharruar, që e kam para syve edhe tani që po shkruaj këto radhë.

Duke zbutur gradualisht zërin, i fola për fajet që kishte bërë, për turpin që i vinte vetes dhe familjes së tij, për telashet që më hapte. Ai nuk më ndërpreu asnjë herë, nuk u justifikua por, sytë nuk mi ndau. Dallova që sytë e tij sa vinin dhe e humbnin egërsinë... E shoqërova deri në kaponon, duke ecur pranë trupit të tij që po dridhej disi. Kaluam poshtë mimozave për t’iu shmangur sadopak shiut të hollë që binte.

Në kaponon, hyra para tij. U afruam te krevati pa bërë zhurmë. Hapa batanijen dhe i bëra shenjë të shtrihej. Ashtu bëri. Për habinë time dhe lumturinë e atij çasti, a i u shtri, jo duke më kthyer shpinën por, përballë meje. U përkula, ia mbulovala supet dhe sytë e mi mbetën të ngulur te pikëza e gjakut mbi buzën e tij. Ajo ishte tharë...!

Të nesërmen në mëngjes, sapo buçiti boria e zgjimit, shkova te vendi ku rreshtoj kompania. Dola para togës dhe, me një qëndrim gatitu, fola me zë të plotë një urdhër që e kisha formuluar orë të tëra gjatë asaj nate të paharruar.

- Toga, gati-tu! Shokë skënderbegas! Duke filluar nga mëngjesi i kësaj dite, zëvendëskomandant i togës,

domethënë, zëvendësi im, do të jetë skënderbegas Shqera!

Një mërmërimë miratimi si valë të një kënge korale u përhap në mjegullën e atij mëngjesi. Shiu kishte pushuar.

- Skënderbegas Shqera!
- Urdhëroni shoku toger!
- Merrni komandën e togës!
- Si urdhëron!

Ai në krye, toga pas tij, nisën vrapin drejt fushës së sportit, duke kënduar një këngë që ua kisha mësuar kohët e fundit. Unë nuk komandoja më togën. Porositë ia jepja zëvendësit tim dhe ato zbatoheshin nga e gjithë toga pa asnjë thyerje disipline.

Komandonte Frederik Shqera.

Një vit më pas u transferova përsëri në Shkollën e Bashkuar. Për Fredin, mora vesh se ishte larguar, pa e mbaruar shkollën.

Kishin kaluar shumë e shumë vite. Unë isha regjisor në Pallatin e Kulturës në Shkodër. Një ditë, dezurni me njofton se dikush më kërkonte te dera e hyrjes.

- Po, ngjite lart, - i thashë.

- Nuk desh, po mu lut të dalësh ti poshtë.

Zbrita, i shkujdesur, e nuk hamendësoja fare se kush mund të ishte. Te kolonat e hyrjes të Pallatit të Kulturës, dallova një burrë rreth të dyzetave. I panjohur për mua.

- O komandant Verdi, po nuk paske ndryshuar fare, o toger Take!

U nisëm të dy drejt njeri-tjetrit. E njoha. Ishte Frederiku. Një shije të hidhur ndjeva në gojë, ashtu ndjeva edhe një farë shqetësimi, (nuk e fsheh).

“Ka ardhur të marrë hak”, - më fërshëllyen në veshë. Ai zgjati duart, më përqafoi dhe pa me lëshuar foli: “O komandanti im! Kam ardhur në Shkodër për t’u furnizuar me disa materiale nga Uzina e Telave. Punoj në sektorin e riparimit të televizorëve. Aty jashtë pushë disa reklama të shfaqjes dhe në të gjitha ishte emri “Regjisor Verdi Take”. Pyeta ku je, dhe ja ku erdha. Nuk mund të shkoja në Elbasan pa të takuar.

Pasi pimë nga një kafe, më vuri dorën në sup dhe foli: “Jam bërë djalë i mirë, komandant. Të faleminderit për gjithçka bërë për mua dhe, të kërkoj falje për shqetësimet që të pata hapur dikur!” Ai i hipi motoçikletës, me çantën e mbushur plot me materiale dhe u nis. Unë, gjithashtu i mbushur me emocione, me mall, e më shumë kujtime nga ato vite, qëndrova “gati-tu” duke e përshëndetur me dorë derisa Fredi kaloi përbri Hotel Turizmit dhe mori kthesën...!

Eh! Skënderbegas... Skënderbegas! E si mund t’iu harrojmë? Jo, kurrsesi! Ju na deshët dhe ne ju donim me shpirt. Qofshi të paharruar!

Përgjegjësia e një fëmije "Perfekt"

Ritja e fëmijëve është fusha më e rëndësishme e jetës sonë. Fëmijët tanë do të jenë pjesëmarrës në procesin historik në cilësi të ndryshme, do të jenë baballarë dhe nëna, do të jenë edukatorë të fëmijëve të tyre. Por kjo nuk është e gjitha: fëmijët tanë janë pleqëria jonë.

Edukimi i duhur, kjo është pleqëria jonë e lumtur, edukimi i keq, ky është pikëllimi ynë i ardhshëm, këta janë lotët tanë, ky është faji ynë para njerëzve të tjerë.

Në ditët e sotme, prindërit shpesh nuk kanë kohë për të qëndruar me fëmijët e tyre, duke qenë se u duhet të kalojnë shumë kohë në punë për të siguruar jetesën e familjes, fëmijët po rriten në duart e njerëzve të panjohur. Është shumë mirë kur prindërit kanë kohë për të komunikuar me fëmijën e tyre të ecin, të luajnë sport ose thjesht të flasnin në shtëpi me vajzën ose djalin e tyre. Shumë shpesh në adoleshencë fëmija dëshiron të ikë nga shtëpia, të kalojë më shumë kohë në rrugë me miqtë, dhe kjo "sepse brenda familjes nuk ka kohë ta dëgjojë njeri".

Prindërimi është akti më delikat i balancimit të gjithë veprimtarive që lidhen me fëmijët tanë.

Shpesh ky ekuilibër është i vështirë për t'u arritur, madje edhe qëllimet më të mira mund të ndikojnë negativisht në rritjen dhe mirëqenien e fëmijëve.

Disa prej gabimeve më të zakonata të prindërve, që në mënyrë të pavullnetshme dëmton rëndë fëmijët, janë sjellje të cilat prindërit për të bërë më të mirën në rritjen e tyre sjellin në familje sjellje të cilat nuk i praktikojnë vetë, por janë të stisura nga formate të tjera.

Dështimi për të praktikuar ato që predikojmë

Është përgjegjësia jonë si prindër t'u rrënjoshim fëmijëve vlerat dhe parimet për një jetë dinjitoze, por nëse sjellja jonë është jo etike dhe nuk përputhet me vlerat që predikojmë, fëmija do të zhvillojë sjellje jo të qëndrueshme që pengojnë marrjen e vendimeve të duhura në jetë. Veprimet flasin më shumë se fjalët në mendjen e një fëmije.

Refuzojmë të ndajmë me ta dështimet tona

Duke krijuar imazhin e prindit perfekt, fëmija ka frikë të gabojë. Dëshira për të mos gabuar dhe të ndjekë shembullin tonë, bën që fëmija të ndrydhë dëshirat dhe pasionet e tij.

Ajo që duhet të bëjmë është të ndajmë me ta dështimet tona, në mënyrë që ata ta kenë të qartë që askush nuk është perfekt. Të gabosh është njerëzore. **Fëmijët duhet të zhvillojnë dëshirat e tyre, duke mos i imponuar në zgjedhjet e tyre**

Është e natyrshme që prindërit duan që fëmijët të ndjekin hapat e tyre, por duhet patur kujdes kur i imponohemi pasi ata mund të kenë interesa krejt të ndryshme nga tonat.

Studimet sociologjike tregojnë se në rritjen e fëmijës ndikojnë: Familja - 50%, media - 30%, shkolla - 10%,



rruga -10%.

Fatkeqësisht, kemi shumë prindër që u shmangen përgjegjësisë të tyre të drejtpërdrejta. Në takimet e prindërve kryesisht shkojnë nënat, akoma dhe me keq gjyshërit.

Prania e prindit baba nuk është mjaftueshëm për djemtë dhe vajzat si në shkollë ashtu edhe në familje. Detyra kryesore e shoqërisë sonë është kthimi i prindërve tek fëmija, sepse suksesi i edukimit varet kryesisht nga familja. Ndonjëherë është e vështirë të kuptosh që atapas lindjes së një fëmije, duke e zhvendosur edukimin e tyre mbi supet e gjyshes, vazhdojnë të jetojnë sikur asgjë në jetën e tyre nuk ka ndryshuar.

Pse të kemi një fëmijë, nëse ai nuk bëhet përmbytja kryesore e mendimeve dhe ndjenjave tona?!

Një fëmijë nuk mund të jetë një shtesë në jetë.

Prindërit nuk kanë kurrë kohë të mjaftueshme për të folur me të. Në një kohë kur ai ende dëshiron të flasë dhe të bëjë pyetje. Dhe kjo kohë kalon kaq shpejt. Sigurisht, ne mund ta rregullojmë jetën tonë në mënyrë që fëmija të mos jetë "barrë e rëndë".

Unë njoh familje të tilla ku edhe krenohen me faktin që prej 6-7 vitesh foshnja ka mbetur vetëm në shtëpi çdo mbrëmje, Ai nuk luan, ai do të shikojë TV dhe do të shkojë në shtrat në kohë. Fëmijë i rehatshëm!? Vetëm se, kur stuhitë të godasin fëmijën, moshë kalimtare, ai do t'u mohojë prindërve të drejtën për t'u interesuar se ku ka qenë, me kë ka ecur, çfarë ka lexuar...

Kur një fëmijë mbetet mbrapa, është e vështirë, e dhimbshme si për të ashtu edhe për prindërit, por nëse është përpara fëmijëve të tjerë, ka edhe shqetësime të mjaftueshme. Një fëmijë i talentuar (dhe prindërit prirën të ekzagjerojnë masën e talentit) zgjon një

bishë shumë të rrezikshme, ambicien prindërore.

Fëmija ulet në piano, mami dhe babi tashmë po imagjinojnë nëse një Mozart po rritet në shtëpinë e tyre. Vizatimet e para sugjerojnë gjithashtu diçka të jashtëzakonshme dhe aftësia matematikore po kështu. Pritshmëritë e prindërve janë një barrë e rëndë mbi supet e fëmijëve, sepse këto pritshmëri duhet të përmbushen. Fatkeqësisht të rriturit shpesh nënvlerësojnë gabimet e fëmijëve dhe madje vullnetarisht ose padashur i inkurajojnë ata. Këtu është pakujdesia e prindërve, mungesa e vëmendjes ndaj interesave të fëmijës, ndaj shokëve të tij. Mungesa e kontrollit të duhur. "Beso, por verifiko". Sigurisht, prindërit duhet ta bëjnë këtë me takt dhe delikatesë, pa cenuar dinjitetin e fëmijës, pa shprehur dyshime, por përkundrazi, në çdo mënyrë të mundshme duke theksuar se e besojnë atë. Për shembull: duke marrë kusurin që ka sjellë djali nga dyqani, mund të thuash: "Të shohim djalin, mendon se ke bërë gabim? Duhet të ketë kaq shumë". Është e rëndësishme që të gjithë të rriturit, dhe veçanërisht prindërit, t'i japin fëmijës vetëm shembuj pozitivë, duke kërkuar nga vetja të njëjtën gjë që kërkohet prej tij. Nëse nëna dhe babai thonë se vjedhja është e turpshme, dhe ata vetë sjellin një copë leshi në shtëpi nga fabrika ku punojnë, fjalët e tyre janë të pavlera, ata do të kryqëzohen nga veprimet e tyre.

Nëse fëmijët shohin vazhdimisht ndershmërinë, respektimin e parimeve, të prindërve, ata rriten njerëz të ndershëm. Prindërit gjatë gjithë kohës duhet të mendojnë se si ai do të jetojë larg tyre, sy i mprehtë mes njerëzve. Si do të ndërtojë marrëdhëniet e veta me të tjerët, dhe një ditë shtëpinë e vet. Familja i jep fëmijës idetë e para për të mirën

dhe të keqen, për normat e moralit, për rregullat e konviktit, aftësitë e para të punës. Pikërisht në familje formohen planet e jetës dhe idealet e një personi. Familja është faktori më i rëndësishëm, duke ndikuar në formimin e personalitetit. Familja vendos themelet për të kuptuarit e botës nga një fëmijë, që në vitet e para ai mëson vlerat morale, normat shoqërore dhe traditat kulturore. Edukimi i fëmijës është i lidhur ngushtë me problemin e formimit të personalitetit të prindërve. Për të rrënjoshur tek një fëmijë përgjegjshmëri, një qëndrim moral ndaj njerëzve, vetë prindërit duhet të jenë në nivelin e duhur.

Të reflektuarit mbi veten dhe ju!

Flisni me fëmijën tuaj për punët tuaja dhe për punët e tij, pavarësisht sa vjeç është fëmija juaj, edhe nëse jeni shumë të lodhur gjatë ditës. Mbani mend, duke ndier keqardhje për veten, po humbisni kohë të çmuar duke krijuar besim. Humbja e besimit të fëmijës, është një humbje e kushtueshme dhe është e vështirë ta kthesh pas. Flisni për dashurinë tuaj me fëmijën tuaj. Nëse më parë keni pasur siklet ta bëni, sot nuk është vonë. Një fëmijë në çdo moshë dëshiron të dëgjojë se është i dashur, të shohë sy të butë. Gjërat e shtrenjta nuk do t'i zëvendësojnë fjalët e tij të sinqerta të dashurisë.

Mos e krahasoni fëmijën tuaj me askënd

Nëse fëmija dëgjon fjalë lavdërimi në krahasim, keni kthyer përmbys botën e tij shpirtërore. Nënndërgjegjja ka marrë informacion se ai është më keq, se nuk është i dashur. Mos u habitni atëherë pse vajza juaj ka cinizëm ose mizori të frikshme. Fëmijët nuk mund të jenë ata që ju pëlqeni. Ju nuk dëshironi t'i pranoni ata ashtu siç janë, dhe ata hakmerren ndaj jush për tradhtinë tuaj. Ky tipar i keq i karakterit mund

të kalojë gjatë gjithë jetës.

Zhvilloni vetëvlerësimin

Çdo dështim nuk duhet të merret si dështim. Nëse keni rënë gjatë rrugës, nuk do të thotë se jeni në rrugën e gabuar. Përdorni autoritetin tuaj. Babi dhe mami për një fëmijë janë ata që i hapin botën e të rriturve. Autoriteti i një të rrituri luan një rol të madh për të në formimin e pikëpamjeve dhe besimeve, kontribuon në formimin e gjykimeve të tij të pavarura, ndikon në sjelljen e tij. Nëse babai fyen nënën para djalit, atëherë ky model perceptohet prej tij si normë. Nëse humori i mirë, prekjet pa vëmendje, buzëqeshja janë të pranishme në familje, kjo perceptohet edhe si normë për fëmijën.

E lumtur është familja ku ka mirëkuptim të ndërsjellë

Vetëm kur jemi bashkë, fëmija ndihet rehat. Dhe kjo është brenda fuqive dhe aftësive tona, rritja e një fëmije me një ide të qartë për shoqërinë. Kjo çon në triumfin e personalitetit të fëmijës. Kjo është rruga e përparimit.

Jeta familjare nuk është vetëm një kënaqësi, por edhe një përgjegjësi e madhe, sidomos kur bëhet fjalë për të mitur që ende nuk mund të jenë plotësisht përgjegjës për veprimet e tyre. Është shumë e rëndësishme të njohësh dhe të kuptosh përgjegjësitë e prindërve në rritjen e fëmijëve.

Një fëmijë nuk mund të jetë një shtesë e jetës, ai duhet të jetë kuptimi i saj.

Nëse të rriturit nuk janë perfekt, nëse çdo ditë pluhurosemi nga rrugëtimi i vështirë i jetës, pse duhet të mos i mësojmë fëmijëve tanë se të qenit "perfekt" nuk ka të bëjë me "tokësorët", se qeniet humane duhet të ecin mes vlerash dhe parimesh krahas njëri - tjetrit, pa i vënë barriera askujt që ec mbi hisen që i takon.

Suedia merr presidencën e BE-së: Çfarë presin eurodeputetët?

Çfarë presin eurodeputetët suedezë nga presidenca

Energjia është një sfidë e rëndësishme për eurodeputetët. Tomas Tobé (EPP) thotë se siguria dhe energjia do të jenë çështje kyçe gjatë presidencës suedeze. “Ne duhet ta mbajmë Evropën të bashkuar dhe të rrisim mbështetjen tonë për Ukrainën për të trajtuar situatën e politikës së sigurisë.”

